

Raport i Vlerësimit të Jashtëm Periodik
Për Programin e Studimit Master Profesional në Menaxhim Biznesi me
Profile:


- **Menaxhim i Turizmit,**
- **Menaxhim i Pasurisë së Paluajtshme,**
- **Menaxhim i Artit,**
- **Menaxhim i Shëndetit,**
- **Menaxhim i Arsimit,**

Ofruar nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof.Asoc. Dr. Doriana Matraku (Dervishi)

Prof.Asoc. Dr. Etleva Leskaj



(Korrik/2018)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Për Programin e studimit Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profile: Menaxhim turizmi;
Menaxhim i pasurive të palujtshme; Menaxhim arti;
Menaxhim shëndeti; Menaxhim arsimit**

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti Mesdhetar I Shqipërisë
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti I Shkencave Ekonomike
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	UMAS Nr 482, dt 03.10.2011
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të pare	VKA Nr 334, dt 08.06.2012 UMAS Nr 291, dt 11.07.2012
5	Titulli i programit të studimit:	Master profesional në Menaxhim biznesi me profile: i. Menaxhim turizmi; ii. Menaxhim i pasurive të palujtshme; iii. Menaxhim arti iv. Menaxhim shëndeti; v. Menaxhim arsimit
6	Cikli i studimit:	Cikli I dytë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 Vit akademik
8	Kreditet në total (ECTS):	60 (ECTS)
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesëshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Ofrohet nga Institucioni
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 7 (shtatë)
16	Aktivizimi i programit të studimit	2011-2012
17	Numri i studentëve	36 studentë
	Etj	

Shenim: Tabela plotësohet nga Specialisti i ASCAL

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profile

Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë" është një institucion privat jofitimprurës i arsimit të lartë që zhvillon veprimtari në fushën e arsimit dhe shkencës në Republikën e Shqipërisë. Ai është projekt i Qendrës Mesdheu, themeluar me Vendimin Nr. 411, datë 06.07.2007. Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë" (UMSH) ka filluar aktivitetin në vitin 2009, bazuar në lejen për hapjen e institucionit "Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë", me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 177, datë 19.02.2009. Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë" është akredituar institucionalisht që nga viti 2012. Në vazhdimësi janë hapur dhe akredituar programet e studimit të ciklit të parë Bachelor dhe ciklit të dytë Master i Shkencave dhe Profesional, të cilat organizohen në UMSH. Aktualisht funksionon si universitet, në bazë të Urdhërit Nr. 273 datë 18.05.2017 të MASR për miratimin e ristrukturimit dhe përbëhet nga tre fakultete: Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike. Programi që vlerësohet në këtë raport, Master Profesional në Menaxhim Biznesi me drejtime: Menaxhim i turizmit, Menaxhim i pasurisë së paluajtshme, Menaxhim i artit, Menaxhim i shëndetit, Menaxhim i arsimit, është hapur në bazë të Urdhërit 482 datë 03.10.2011 të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës dhe është akredituar për herë të parë në bazë të Urdhërit 291 datë 11.07.2012 të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës. Programi i studimit Master Profesional në Menaxhim Biznesi është pjesë përbërëse e programeve të studimit të ciklit të dytë që ofron FSHE, me kohëzgjatje një vit dhe i organizuar sipas programeve të studimit me kohë të plotë. GVJ referuar vizitës në institucion dhe të dhënave të siguruara nga RVB, konstatohet se ky Fakultet ka në përbërje të tij, një personel akademik të përbërë nga 59 pedagogë, nga të cilët 39 personel akademik efektiv dhe 20 personel akademik me kontratë, ndër të cilët 14 anëtarë janë me tituj/ grada. Departamenti të Ekonomisë, për vitin akademik 2017-2018 në përbërje të tij janë 18 pedagogë në 2017-2018, nga të cilët, 13 pedagogë, janë personel akademik efektiv dhe 5 pedagogë janë personel akademik joefektiv. Për sa i përket kualifikimit të stafit të departamentit, 4 anëtarë të personelit akademik efektiv, janë me tituj/ grada për vitin 2017-2018 ndërsa 100% e stafit joefektiv është e kategorisë profesor. Në PS MPMB, janë të angazhuar 13 pedagogë nga të cilët 11 pedagogë janë staf efektiv i UMSH, dhe 2 prej tyre janë staf joefektiv, për vitin akademik 2017-2018. Staf efektiv i angazhuar, përbëhet nga 2 pedagogë të kategorisë profesorë, 7 anëtarë kanë gradën doktor, dhe 2 janë në proces doktorature. Staf joefektiv i përket kategorisë profesor.

Plani mësimor i PS MPMB përmban 60 ECTS. Veprimtaritë formuese të programit janë të formimit të përgjithshëm dhe të formimit karakterizues (gjithsej 46 ECTS), praktikë profesionale (6 ECTS) dhe Teza e diplomës ose provim perfundimtar (8 ECTS).

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

1.Prof.Asoc.Dr Doriana (Matraku) Dervishi

2.Prof.Asoc.Dr.Etleva Leskaj

Menaxhere teknike për ndjekjen e këtij programi është Znj Suela Kromidha, ASCAL

Më datë 19.06.2018 nëpërmjet sistemit AMS, Universiteti Mesdhetar I Shqipërisë është njohur me Draft RVJ e vlerësimit të jashtëm. UMSH përcjell në ASCAL me shkresë Nr 301/7, dt 26.06.2018 Objeksionet në lidhje me Draft RVJ. Grupi I vlerësimit të jashtëm, pasi u njoh me përgjigjen e UMSH, vendosi që të marrë në konsideratë vetëm dy prej këtyre objeksioneve, duke i reflektuar në Raport. Më konkretisht në lidhje me përgjigjen e UMSH, GVJ sqaron për disa pika sa më poshtë:

I. Analiza e komenteve të UMSH lidhur me rekomandimet e akreditimit të parë

- i. Në lidhje me këtë objeksion të UMSH, institucioni sqaron se ka shtuar në sistem syllabuset e programit të studimit për të gjitha vitet akademike.

Sqarojmë se në sistem institucioni ka shtuar vetëm syllabuse MPMB për vitin 2012-2013 sic e emërton vet institucioni në sistem, pasi në syllabuse nuk është e evidentueshme viti akademik. Nuk janë të gjitha vitet (periudha e akreditimit) sic pretendon institucioni.

- ii. Në lidhje me këtë objeksion të UMSH, bëjmë me dije se nuk na është dorëzuar asnjë dokument që të vërtetojë fushatën promovuese të bërë nga institucioni. Për më tepër mendojmë se numri i mjaftueshëm për të hapur një program studimi duhet të variojë nga 10-15 studentë. I mbetemi qëndrimit fillestar të gjykimit tonë.
- iii. Përgjigja është e njëjtë si në pikën i në lidhje me paraqitjen e syllabuseve.
- iv. Përgjigja është e njëjtë si në pikën i në lidhje me paraqitjen e syllabuseve.

v. **Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil "Menaxhim Arsimi"**

c- Nuk ka ndryshim në qëndrimin tonë. Institucioni duhet të bëjë një studim të detajuar tregu vetëm për këtë program studimi.

d- **UMSH e ka plotësuar kryesisht këtë rekomandim.** Në stafin akademik janë rekrutuar persona me eksperiencë në fushën e arsimit, por GVJ sugjeron që institucioni të rrisë në vazhdim numrin e e stafit akademik efektiv për këtë profil. [Referuar draftRVJ]

Qendrimi i GVJ: Duke qene se rekomandimi i akreditimit te meparshem ka te beje me shtimin e stafit efektiv, dhe nga objeksionet e paraqitura, institucioni argumenton se ne kete program studimi, ne profilin Menaxhim Arsimi perfshihen ne mesimdhenie jo vetem staf efektiv i FSHE, por edhe staf efektiv i fakultetit te Shkencave Psikologjike Sociale dhe Politike, te cilet mbajne grada dhe kane experience ne fushen e arsimit, GVJ vendosi ta pranoje kete argumentim te institucionit. **Persa me siper konkludojme se UMSH e ka plotesuar kete rekomandim**

g- **UMSH e ka plotësuar kryesisht këtë rekomandim.** Sipas RVB dhe nga verifikimi i GVJ, institucioni ka një faqe interneti umsh.edu.al, informative dhe funksionale për studentët dhe pedagogët, por që duhet të ofrojë një informacion më të plotë në lidhje me programet e lëndëve, politikën e praktikës profesionale, politikën e vlerësimit, listën e personelit, temat e mikrotezave dhe listën e udhëheqësve, veprimtaritë shkencore në kuadrin e programit [Referuar draftRVJ]

Qendrimi i GVJ: Institucioni ne objeksionet e paraqitura argumenton se informacion shtese ne faqen zyrtare te internetit te UMSH-se, per politikate e vleresimit, listen e personelit, listen e udheheqesve etj, ofrohen ne "Portalin e Pedagogut", ku perdoruesit e jashtem nuk kane akses. GVJ vendosi ta pranoje kete argumentim te institucionit. Persa me siper konkludojme se UMSH e ka plotesuar kete rekomandim

II. Analiza e komenteve te UMSH lidhur me fushat e perfshira ne RVJ

[Referuar draftRVJ fq 16/59] Referuar vizitës në institucion, GVJ konstatoi pasaktësi në mbajtjen e regjistrave të studentëve të PS MPMB, aktivitete këto që realizohen nga stafi administrativ. Për të rritur efektivitetin e këtij stafi, por dhe për të përmbushur detyrimet që burojnë nga kontrata e punës, GVJ sugjeron trajnime të vazhdueshme dhe mbikëqyrje të këtij stafi për përmbushjen e detyrimeve të tij.

Qendrimi i GVJ: GVJ deshiron te theksoje se vlereson perpjekjet e institucionit per te permiresuar sistemin e informacionit dhe instalimin e sistemit te Manaxhimit te Studenteve i cili sic paraqitet ne objeksionin e institucionit, eshte plotesisht funksional gjate vitit 2017-2018, por pavaresisht ketyre argumenteve GVJ gjate vizites ne isntitucion, konstatoi pasaktesi ne mbajtjen e regjistrave manual per studentet e PS MBMP, te cilat ju bene prezent punonjesve administrativ perkates si dhe drejtuesve te institucionit. Per sa me siper, GVJ rikonfirmon analizen dhe konkluzionin e nxjerre ne raportin derguar institucionit

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit për programin Master profesional në Menaxhim Biznesi, sipas profileve, VKA nr. 334, dt. 08.06.2012 për:

i. Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil "Menaxhim Turizmi"

- a) Të përmirësohen programet mësimore për t'u përshtatur me zhvillimin ekonomik dhe turistik të vendit.
- b) Të përmirësohen kurrikulat për të qënë në përputhje me emërtimin e diplomës.
- c) Të shtohen apo të zëvendësohen disa prej kurrikulave për t'i shërbyer formimit të mirëfilltë të menaxhimit turistik.
- d) Të rritet numri i stafit të brendshëm apo të jashtëm, ose me status të ftuar të përgatitur në fushën e Menaxhim Turizmit.
- e) Të sigurohet që studentët e këtij programi studimi duhet të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.

ii. Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil "Menaxhim i Pasurive të Paluajtshme".

- a) Institucioni të mendojë për një fushatë të drejtë promovimi për këtë lloj programi midis palëve të interesuara.
- b) Institucioni të fokusohet në ngritjen e kapaciteteve të personave që merren kryesisht me menaxhimin e pasurive të paluajtshme.
- d) Institucioni duhet të thellojë punën për të tërhequr personel shumë të kualifikuar në fushat specifike të programit të studimit të Menaxhimit të Pasurive të Paluajtshme.
- c) Të kryhet në mënyrë sistematike për të gjitha programet e studimit kontrolli i cilësisë duke përdorur reagime edhe nga studentët.
- e) Të realizohet në mënyrë elektronike për t'u vënë në dispozicion për të gjithë studentët informacione për të gjitha planeve, eventet, materialet për të gjitha modulet dhe rezultatet individuale studimore.
- f) Të sigurohet që studentët e këtij programi studimi duhet të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.

iii. Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil "Menaxhim Arti"

- a) Të vendoset në planin mësimor një numër orësh teorike formuese mbi artin për menaxherët e artit.
- b) Të merren masat për organizimin konkret të praktikës mësimore
- c) Të merren masa për përcaktimin e fushave ku mund të zhvillohen mikrotezat dhe të shpallen paraprakisht ato për t'u njohur nga studentët
- d) Të shihet mundësia e aplikimit të ndonjë kriteri për gjuhën angleze para fillimit të studimit në programin e nivelit të dytë.

e) Të sigurohet që studentët e këtij programi studimi duhet të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.

iv Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil "Menaxhim Shëndeti"

a) Të rishihet shpërndarja e lëndëve/moduleve/krediteve, literaturës bashkëkohore në lidhje me profilin e programit të studimit duke pasur parasysh profilin specifik të menaxhimit të shëndetit.

b) Institucioni të fokusohet më shumë në rritjen e nivelit të kërkimit shkencor, të përfshijë më shumë studentët në të si detyrim që ka ky nivel studimesh.

c) Të kualifikohet stafi akademik në drejtimin e menaxhimit të shëndetit si dhe të ndiqen politika rekrutimi në të ardhmen për më të specializuar.

d) Të synohet rritja e nivelit të bashkëpunimit me grupet e interesit dhe sektorin shëndetsor.

e) Të vendoset si kriter specifik për pranimin e studentëve në këtë program studimi, gjuha e huaj angleze si detyrim ligjor.

f) Të sigurohet që studentët e këtij programi studimi duhet të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.

iv. Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil "Menaxhim Arsimi"

a) Të plotësohet korniza rregullatore me rregulla për kërkimin shkencor, praktikën profesionale, për procedurën e diplomimit, për pronësinë intelektuale, për regjistrimin dhe ruajtjen e të dhënave të IAL-së, të studentëve dhe të personelit.

b) Të plotësohet dokumentacioni që orienton zhvillimin e IAL-së dhe të politikave të veçanta të tij si, dokumenti i planit strategjik të zhvillimit, dokumenti i politikës së kërkimit shkencor, dokumenti i politikës së sigurimit të brendshëm të cilësisë, dokumenti i praktikës profesionale, dokumenti i vlerësimit të studentëve.

c) Të behet studimi i tregut në mënyrë që të sigurohet një numër më i madh i studentëve për të realizuar me efikasitet programin.

d) Të rritet numri e pedagogëve me kohë të plotë.

e) Të institucionalizohet sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë që të garantoj monitorimin dhe vlerësimin periodik të cilësisë në IAL.

f) Të krijohet një sistem elektronik i të dhënave dhe të përmirësohet regjistrimi i të dhënave të shkuara nga sekretaria mësimore.

g) Të pasurohet faqja e internetit e IAL-së që të informojë dhe të garantojë transparencë për programin e studimit "Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimi" duke publikuar planin mësimor, programet e lëndëve, rregulloren e studimeve, politikën e kërkimit, politikën e praktikës profesionale, politikën e vlerësimit, listën e personelit, temat e mikrotezave dhe listën e udhëheqësve, veprimtaritë shkencore në kuadrin e programit.

h) Të sigurohet që studentët e këtij programi studimi duhet të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

i. Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil “Menaxhim Turizmi”

a) b) dhe c) institucioni ka bërë vetëm dy ndryshime në planin mësimor përsa I përket dy moduleve. “Promocioni” u përshtat dhe u zëvendësua me “Promocioni në turizëm” si dhe “Sigurimi dhe higjena në ushqim” u zëvendësua nga “Sigurimi dhe higjena në ushqim-sistemet hotelerike dhe restoranteria”. Nuk ka ndryshuar ngarkesa mësimore dhe institucioni nuk I ka dhënë të dy syllabuset për të kuptuar ndryshimet përkatëse. Institucioni nuk përmend vitin akademik në të cilin ka bërë këtë ndryshim. **UMSH e ka plotësuar pjesërisht rekomandimin.**

d) **UMSH e ka plotësuar këtë rekomandim.** GVJ nga vizita në institucion, nga dokumenti i siguruar pas vizitës, nga dosjet e stafit, konstaton se institucioni ka rritur numrin e personeli PAE dhe PAK, të specializuar dhe me eksperience akademike në fushën e menaxhimit të turizmit. F. Ozuni PAE prej 2013, është i diplomuar në fushën e turizmit dhe me eksperiencë në këtë sektor. [Dokumenti 28 Shtojce Sqarime per RVB MP MB me profile.pdf, vizita në institucion, Dokumenti 5, arshiva]

e) **UMSH e ka plotësuar këtë rekomandim,** mbështetur në zbatim e detyrueshëm të Udhëzimit nr. 14, datë 28.03.2011, LALKSH 80/2015 dhe udhëzimit Nr. 62 të MASR datë 03.12.2015, për mbrojtjen e gjuhës së huaj

ii. Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil “Menaxhim i Pasurive të Paluajtshme”.

a) Institucioni nuk ka realizuar fushata promovimi për këtë profil të programit të studimit. Në RVB nuk ka asnjë dokument të tillë, nga vizita në institucion nuk na u pasqyrua ndonjë nismë e tyre, dhe për më tepër numri I vogël në këto vite I studentëve në këtë program (varion nga 4-7 studentë) tregon për mos promovim të PS. **UMSH nuk e ka plotësuar këtë rekomandim.**

b) **UMSH e ka plotësuar këtë rekomandim.** GVJ referuar dokumentacionit të siguruar gjatë vizitës në institucion, takimit me drejtuesen e njësisë bazë, konstaton se institucioni për rritjen e cilësisë së mësimdhënies në këtë profil, ka angazhuar personel të specializuar për të realizuar programin e studimit si I.Gjika (2014), V.Resuli (2016), N.Pano (2015), D.Avduli(2014), të certifikuar për vlerësimin e pasurive të paluajtshme etj. [Dokumenti 28 Shtojce Sqarime per RVB MP MB me profile.pdf, vizita në institucion, Dokumenti 5, arshiva]

c) **UMSH e ka plotësuar këtë rekomandim** GVJ referuar dokumentacionit të siguruar gjatë vizitës në institucion, takimeve me përfaqësues të NJSBCZHK, drejtuesen e njësisë bazë, konstaton se institucioni ka riorganizuar NJSBCZHK në nëntor të 2017. Kjo njësi operon sipas një plani, përdor metodologji vlerësimi me metoda alternative si pyetësor dhe fokus grupe për të siguruar informacionin mbi opinonin e studentëve për këtë programin e studimit, apo ushtrimin e kontrolleve vertikale nga strukturat drejtuese në koordinim me NJSBCZHK. [Dokumenti 28 Shtojce Sqarime per RVB MP MB me profile.pdf, vizita në institucion, Dokumenti 7 “Relacion mbi rezultatet e anketimit studentor 2017”]

d) **UMSH e ka plotësuar këtë rekomandim** GVJ referuar dokumentacionit të siguruar gjatë vizitës në institucion, takimit me drejtuesen e njësisë bazë rezulton se institucioni ka angazhuar ne ore të veçanta leksioni

personel të specializuar nga hipoteka, Bashkia e Tiranës, dhe disa zyra të vlerësimit të pasurive të paluajtshme
[Dokumenti Plotësimi i rekomandimeve, vizita në institucion]

e) Institucioni ka përmirësuar në mënyrë të ndjeshme komunikimin me studentët qoftë nëpërmjet tutoriatit pra formave të drejtpërdrejta dhe nëpërmjet formave elektronike jo vetëm për shpërndarjen e materialeve por dhe komunikimi në sezonet e provimit. Regjistrimi në bibliotekën elektronike Questia rrit mundësinë e përmirësimit të informacionit. **UMSH e ka plotësuar këtë rekomandim.**

f) **UMSH e ka plotësuar këtë rekomandim**, mbështetur në zbatim e detyrueshëm të Udhëzimit nr. 14, datë 28.03.2011, LALKSH 80/2015 dhe udhëzimit Nr. 62 të MASR datë 03.12.2015, për mbrojtjen e gjuhës së huaj

iii. Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil “Menaxhim Arti”

a) Institucioni nuk ka ndryshuar planin mësimor por vetëm syllabusin e lëndës “Menaxhimi I Eventeve” duke shtuar temat teorike për artin. Institucioni nuk ka dorëzuar të dy syllabuset për të parë ndryshimet për të gjykuar se në çfarë mase ky ndryshim ka ndodhur. **UMSH ka plotësuar pjesërisht rekomandimin.**

b) Institucioni ka shtuar marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione publike dhe private. Vet studentët gjatë periudhës së ndjekjes së këtij program janë të punësuar, dhe në këtë profil studentët janë më pranë institucioneve të artit. **UMSH ka plotësuar këtë rekomandim.**

c) **UMSH e ka plotësuar këtë rekomandim.** Nga vizita në institucion, GVJ siguroi informacion për listën e temave që evidenton fushat kryesore të studimit në këtë profil [Dokumenti 26, Propozim fusha tema për diplomat Master_2017-18.pdf, vizita në institucion]

d) **UMSH e ka plotësuar këtë rekomandim** Institucioni ka zbatuar detyrimet ligjore në fuqi në kohën e regjistrimit të studentëve, lidhur me provimin e gjuhës së huaj para fillimit të studimeve në këtë program.

e) **UMSH e ka plotësuar këtë rekomandim**, mbështetur në zbatim e detyrueshëm të Udhëzimit nr. 14, datë 28.03.2011, LALKSH 80/2015 dhe udhëzimit Nr. 62 të MASR datë 03.12.2015, për mbrojtjen e gjuhës së huaj

iv. Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil “Menaxhim Shëndeti”

a) Institucioni ka pohuar se ka kryer ndryshime në syllabuset duke përmirësuar literaturën bazë dhe ndihmëse. Institucioni nuk ka pasqyruar syllabuset para dhe pas ndryshimit për të vlerësuar për këtë rekomandim. Gjykojmë se **UMSH nuk e ka plotësuar rekomandimin.**

b) **UMSH e ka plotësuar këtë rekomandim.** Studentët e këtij profili kanë realizuar punime diplome dhe kanë marrë pjesë në Panairin e ideve. Institucioni është përpjekur të përfshijë dhe në konferencat e organizuara në bashkëpunim me autorë të tjerë.

- c) **UMSH e ka plotësuar këtë rekomandim** GVJ referuar dokumentacionit të siguruar gjatë vizitës në institucion, takimit me drejtuesen e njësisë bazë, dhe dosjeve të personelit akademik, konstaton se institucioni për rritjen e cilësisë së mësimdhënies në këtë profil ka angazhuar personel të specializuar dhe me eksperiencë të gjatë pune në fushën e shëndetit si A. Gajo (2014), M.Lika (2012). [Dokumenti 28 Shtojce Sqarime per RVB MP MB me profile.pdf, vizita në institucion, Dokumenti 5, arshiva]
- d) Institucioni ka shtuar marrëveshjet e bashkëpunimit për të gjitha profilet. **UMSH e ka plotësuar këtë rekomandim**
- e) **UMSH e ka plotësuar këtë rekomandim.** GVJ konstaton se institucioni ka rritur numrin e personeli PAE dhe PAK, të specializuar dhe me experience akademike në fushën e menaxhimit të turizmit.
- f) **UMSH e ka plotësuar këtë rekomandim,** mbështetur në zbatim e detyrueshëm të Udhëzimit nr. 14, datë 28.03.2011, LALKSH 80/2015 dhe udhëzimit Nr. 62 të MASR datë 03.12.2015, për mbrojtjen e gjuhës së huaj

v. **Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil “Menaxhim Arsimi”**

- a) **UMSH e ka plotësuar këtë rekomandim.** Kalimi nga SHLP në Universitet ka rregulluar të gjitha aktet rregullatore.
- b) **UMSH e ka plotësuar këtë rekomandim** GVJ referuar dokumentacionit të siguruar nga institucioni, konstaton se UMSH ka formalizuar Dokumentin e strategjisë institucionale, Strategjinë e PS MPMB, atë të kërkimit shkencor, Manualin dhe rregulloren e NJSBC, rregulloren e praktikave dhe të mikrotezës etj.
- c) institucioni ka paraqitur një studim tregu për të gjitha programet e studimit. Studimi nuk është specific për këtë program dhe nuk mund të paraqesë nevojat e tregut për cdo profil. Gjykojmë se me kapacitetet që ka UMSH mund të realizojë një studim më të detajuar dhe më produktiv. **UMSH e ka realizuar pjesërisht këtë rekomandim.**
- d) **UMSH e ka plotësuar këtë rekomandim.** Duke qene se rekomandimi i akreditimit të meparshem ka të beje me shtimin e stafit efektiv dhe institucioni argumenton se në këtë program studimi, në profilin “Menaxhim Arsimi” përfshihen në mesimdhënie jo vetëm staf efektiv i FSHE, por edhe staf efektiv i fakultetit të Shkencave Psikologjike Sociale dhe Politike, të cilët mbajnë gradën shkencore dhe kanë experience në fushën e arsimit, GVJ konkludon se UMSH e ka plotësuar këtë rekomandim
- e) **UMSH e ka plotësuar këtë rekomandim** GVJ referuar dokumentacionit të siguruar gjatë vizitës në institucion, takimeve me përfaqësues të NJSBCZHK, drejtuesen e njësisë bazë, konstaton se institucioni ka institucionalizuar dhe riorganizuar NJSBCZHK në nëntor të 2017. Veprimtaria e NJSBCZHK është e rregulluar sipas Manualit të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBCZHK) dhe rregullores së NJSBCZHK, të miratuar në 2017. NJSBCZHK përbëhet nga 7 anëtarë, të cilët janë në këtë detyrë prej nëntorit të 2017. NJSBCZHK ka në përbërje edhe përfaqësues të studentëve dhe nga stafi administrativ. Kjo njësi operon sipas një

plani, përdor metodologji vlerësimi me metoda alternative si pyetësor dhe fokus grupe dhe harton një raport për gjetjet që rezultojnë [Dokumenti 28 Shtojce Sqarime per RVB MP MB me profile.pdf, vizita në institucion, Dokumenti 7 “Relacion mbi rezultatet e anketimit studentor 2017”]

f) **UMSH e ka plotësuar këtë rekomandim** GVJ nga vizita në institucion, takimet me drejtues të njësisë bazë, personel akademik dhe studentet, konstatoi se institucioni ka përmirësuar komunikimin elektronik student-pedagog për materialet e studimit, për procedurat e vlerësimit, për komunikimin e rezultateve të provimeve nëpërmjet sistemit informatik.

g) **UMSH e ka plotësuar këtë rekomandim.** Sipas RVB dhe nga verifikimi i GVJ, institucioni ka një faqe interneti umsh.edu.al, informative dhe funksionale për studentët dhe pedagogët. Institucioni ne objeksionet argumenton se informacion shtese ne faqen zyrtare te internetit te UMSH-se, per politikat e vleresimit, listen e personelit, listen e udheheqesve etj, ofrohen ne “Portalin e Pedagogut”, ku perdoruesit e jashtem nuk kane akses. Persa me siper konkludojme se UMSH e ka plotesuar kete rekomandim

h) **UMSH e ka plotësuar këtë rekomandim**, mbështetur në zbatim e detyrueshëm të Udhëzimit nr. 14, datë 28.03.2011, LALKSH 80/2015 dhe udhëzimit Nr. 62 të MASR datë 03.12.2015, për mbrojtjen e gjuhës së huaj

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Programi Master Profesional në Menaxhim Biznesi me drejtime: Menaxhim i turizmit, Menaxhim i pasurisë së paluajtshme, Menaxhim i artit, Menaxhim i shëndetit, Menaxhim i arsimit, është hapur në bazë të Urdhërit 482 datë 03.10.2011 të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës dhe është akredituar për herë të parë në bazë të Urdhërit 291 datë 11.07.2012 të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës. Programi i studimit Master Profesional në Menaxhim Biznesi, me profile është pjesë përbërëse e programeve të studimit të ciklit të dytë që ofron FSHE pranë UMSH, me kohëzgjatje një vit dhe i organizuar sipas programeve të studimit me kohë të plotë. Referuar RVB, strategjisë së programit MP në Menaxhim Biznesi, si edhe informacionit të marrë, gjatë vizitës në institucion, Programi Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profile Menaxhim i turizmit; Menaxhim i pasurisë së paluajtshme; Menaxhim i artit; Menaxhim i shëndetit; Menaxhim i arsimit, ka si qëllim formimin e ekspertëve dhe specialistëve të mirëfilltë në fushën e menaxhimit të kompanive dhe organizatave në sektorët e turizmit, pasurive të paluajtshme, artit, shëndetit dhe arsimit.

Pas përfundimit të programit master profesional në Menaxhim biznesi me profile, pranë UMSH-së, synohet që studenti të jetë aftësuar si menaxher me një nivel të lartë njohurish teorike, praktike dhe profesionale dhe mundësinë më të larta punësimi si në sektorin privat dhe në ate publik, në nivel qendror dhe lokal (menaxhere të kompanive turistike; kompanive artistike; menaxhere dhe administratore në fushën e arsimit dhe të shëndetit publik e privat; të kompanive të shërbimeve; mundësi të mira vetëpunësimi). Përfundimi me sukses i këtij programi studimi u mundëson studenteve të këtij programi, rritjen e shanseve për zhvillimin e mëtejshëm të karrierës së tyre profesionale. [Dokument 13, Strategjia e programit, arshive]

Programi MP në Menaxhim Biznesi me profile, synon të nxisë dhe motivojë bashkëpunimin e ngushtë të personelit akademik, joakademik, administrativ dhe studentëve, në përputhje me statutet e tyre, funksionet dhe përgjegjësitë, për arritjen dhe realizimin e qëllimeve institucionale. Programi promovon zhvillimin e lirë të studimit, procesit mësimor dhe të kërkimit shkencor, bashkëpunimin në shkallë të gjerë me institucione të arsimit të lartë dhe të kulturës kombëtare dhe ndërkombëtare, me synim zhvillimin e mëtejshëm të karakterit filantropik të institucionit duke u kthyer në një qendër të rëndësishme të zhvillimit arsimor dhe shkencor të vendit. [Dokument 13, Strategjia e programit, arshive]

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij. Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit; Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës; Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit; Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.	GVJ konstaton se programi i studimit, "Master Profesional në Menaxhim Biznesi", pranë UMSH-së, është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit. Referuar strategjisë së këtij PS (program studimi), GVJ konstaton se kjo strategji pasqyron vizionin e UMSH-së, për politikën aftagjate dhe afatmesme në mësimdhënie, në përvetësimin e dijeve si dhe për kërkimin shkencor. Ky PS paraqitet thellësisht i diversifikuar duke qenë, se synon aftësimin e studentëve në 5 fusha specifike të tregut të punës, me synimin për t'u përshtatur kërkesave të këtij tregu. GVJ konstatoi se UMSH ka kryer një

	<p>studim të tregut të punës, për të identifikuar kërkesat e këtij tregu dhe për të përshtatur programet e studimit, me këto kërkesa. Ky studim është bërë në 2015. [Shtojca14: Dokumenti Analiza e tregut të punës]</p> <p>Sugjerohet që institucioni të ndërmarrë vazhdimisht studime të tregut të punës, për këto profile që ky PS ofron, për të reflektuar prioritetet e këtij tregu, në kurrikulat e programit.</p> <p>PS në MPMB është hartuar në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit, në 5 fusha specifike, si Menaxhim i turizmit; Menaxhim i pasurisë së paluajtshme; Menaxhim i artit; Menaxhim i shëndetit dhe Menaxhim i arsimit.</p> <p>PS në MPMB, pasqyron vullnetin e institucionit për ruajtjen dhe transmetimin e vlerave kulturore të kombit.</p>
<p>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>GVJ, referuar informacionit të siguruar nga takimet me drejtues të njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për këtë PS, RVB-së, si dokumentacionit të arshivuar, konstaton se PS, MPMB me profile, është përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit. PS synon të nxisë dhe motivojë bashkëpunimin e ngushtë të personelit akademik, joakademik, administrativ dhe studentëve, për arritjen dhe realizimin e qëllimeve institucionale. Programi promovon zhvillimin e lirë të mendimit, procesit mësimor dhe të kërkimit shkencor, bashkëpunimin në shkallë të gjerë me institucione të arsimit të lartë dhe të kulturës kombëtare dhe ndërkombëtare, me synim zhvillimin e mëtejshëm të karakterit filantropik të institucionit, duke qenë në përputhje me strategjinë e institucionit. [Dokumenti13, Strategjia e programit, arshive]</p>
<p>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>GVJ vlerëson se përmbatja e programit të studimit MPMB, me profile, është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Programi zbaton kërkesat e akteve rregullore të institucionit, në formën e rregulloreve dhe udhëzimeve të përgjithshme dhe specifike për programin. [Dokumenti 12, Rregullore Programit, arshive]</p> <p>Emërtimi i programit të studimit, është në përputhje me orientimet e Kornizës Shqiptare të Kualifikimit. Emërtimi i këtij programi reflekton edhe fushën specifike të kualifikimit dhe specializimit të studentit, duke qenë se është e specifikuar edhe ndarja në 5 profile.</p>
<p>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>UMSH harton një plan strategjik në nivel institucioni, me fokus zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve, përmirësimin të kurrikulave, ngritja e nivelit të cilësisë së stafit akademik, përmirësimin të rezultateve të mësimdhënies dhe sigurimit të cilësisë, si dhe intensifikimin e kërkimit shkencor dhe inovacionit</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>1. UMSH, ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</p>	

2. Programi i studimit "Master Profesional" në "Manaxhim Biznesi", me profile, është në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.
3. Ky program studimi me profile, ofrohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
4. UMSH harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.

GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni, vizitat në institucion dhe informacionin shtesë të siguruar gjatë këtyre vizitave, konkludon se **standardet e kësaj fushe janë plotësuar.**

2. Struktura akademike e Fakultetit (departamentit përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Fakulteti i Shkencave Ekonomike pranë UMSH aktualisht ka tre departamente: Departamenti i Ekonomisë, Departamenti Financë Bankë dhe Kontabilitet dhe Departamenti i Informatikës dhe i Formimit Shkencor (Vizita ne institucion, Dokumenti 17:Universiteti Mesdhetar - Struktura e Njesive.pdf) Ne secilin prej departamenteve ofrohen programe studimi të ciklit te pare dhe të ciklit te dytë. Departamenti Financë, Bankë, Kontabilitetit dhe Departamenti i Ekonomisë bashkëorganizojnë programin e studimit Bachelor në Shkenca Ekonomike me tre profile: Financë Bankë dhe Kontabilitet, Administrim Biznesi dhe Biznes dhe Ligj.

Departamenti i Ekonomisë ofron programet:

- Master Profesional në Administrim Biznesi dhe
- Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profile: Menaxhim Arsimi; Menaxhim Arti; Menaxhim Shëndeti; Menaxhim i Pasurive të Paluajtshme; Menaxhim Turizmi.

Departamenti Financë, Bankë, Kontabilitetit ofron:

- Master i Shkencave në Financë Bankë.

Departamenti i Informatikës dhe i Formimit Shkencor ofron programin:

- Bachelor në Informatikë Biznesi dhe dy programe te ciklit te dytë
- Master i Shkencave në Sisteme Informacioni në Biznes dhe
- Master Profesional në Sisteme Informacioni në Biznes

Fakulteti ka në përbërjen e tij 59 anëtarë të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, si dhe personel administrativ që është në shërbim të punës kërkimore dhe shkencore të të gjithë programeve. Personel akademik efektiv janë gjithsej 39 persona, nga të cilët 14 janë personel akademik me grada dhe tituj. Personel akademik me kontratë janë 20 persona, ndër të cilët të gjithë janë me grada dhe tituj. **[Aneks Tabela 2.1]**

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Struktura akademike e Fakultetit

Dekani është autoriteti drejtues në secilin prej fakulteteve të Universitetit. Strukturat përbërëse të Universitetit janë njësitë kryesore, njësitë bazë dhe njësi të tjera të ngritura pranë universitetit dhe të përcaktuara në statut. Dekani i Fakultetit të Shkencave Ekonomike, ku edhe ofrohet programi i studimit MP Administrim Biznes me profile është Prof.asoc. Dr. Alqi Naqellari.

Përgjegjësi i Njësitë bazë (departamentet) është autoriteti drejtues i njësisë bazë. Njësi bazë të Universitetit “Mesdhetar i Shqipërisë” pranë Fakultetit të Shkencave Ekonomike janë:

- Departamenti i Financë, Bankë dhe Kontabilitet
- Departamenti i Ekonomisë
- Departamenti i Informatikës dhe i Formimit Shkencor

Fakulteti i Shkencave Ekonomike pranë UMSH aktualisht ka tre departamente: Departamenti i Ekonomisë, Departamenti Financë Bankë dhe Kontabilitet dhe Departamenti i Informatikës dhe i Formimit Shkencor [Vizita ne institucion, Dokumenti 17:Universiteti Mesdhetar - Struktura e Njesive.pdf] GVJ referuar kësaj strukture, mendon se kjo strukturë është në funksion të plotë të programit të studimit, të përmbushjes së objektivave si dhe të implementimit të strategjisë që institucioni ka për këtë programi studimi

Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës
 Stafi akademik i departamentit të Ekonomisë, përbëhet nga 18 anëtarë, nga të cilët 13 janë staf akademik efektiv, prej të cilëve 1 mban titullin prof./asoc dhe 4 gradën doktor. Stafi i jashtëm përbëhet prej 5 anëtarëve të kategorisë profesor. Të dhënat për stafin akademik të departamentit të Ekonomisë, paraqiten në tabelën 2.2, në shtojcë. GVJ gjatë vizitës në institucion nuk konstatoi ndryshime nga të dhënat e referuara në RVB. Përgjegjëse e Departamentit të Ekonomisë është Dr. Ira Gjika.

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
	Referuar RVB, vizitës në institucion si dhe dokumentave shtesë të siguruar gjatë vizitës në institucion, GVJ vlerëson se organizimi i UMSH është në mbështetje të përmbushjes së misionit të tij.[Dokument 16, UMSH - Strukturë Organizative, vizita në institucion]
<p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	<p>Referuar strukturës organizative të IAL-së, UMSH përbëhet nga tre njësi kryesore: Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Ekonomike përbëhet nga 3 njësi bazë, Departamenti i Ekonomisë, , Departamenti Financë Bankë dhe Kontabilitet dhe Departamenti i Informatikës dhe i Formimit Shkencor [Vizita ne institucion, Dokumenti 17:Universiteti Mesdhetar - Struktura e Njesive.pdf]</p> <p>GVJ konstaton se Departamenti i Ekonomisë, që është përbërës për PS MPMB, përbëhet nga 13 anëtarë, ndër të cilët 1 mban titullin Prof./asoc dhe 3 mbajnë gradën “Doktor i shkencave” [Tabela 2.2 shtojca bashkëlidhur]</p>
Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe informacioni i siguruar nga takimet me drejtues të njësisë kryesore dhe njësisë bazë, rezulton se këto struktura janë të ndërgjegjshme për realizimin e PS MPMB. Veprimtaria e fakultetit dhe e secilit prej departamenteve të FSHE realizohet duke u</p>

mbështetur në aktet rregullative të UMSH [Dokumenti 18.Statuti, Dokumenti 31.Rregullorja Fakultetit të Shkencave Ekonomike, Dokumenti 27.Rregullore e Departamenti i Ekonomisë]
Referuar takimit me drejtuesen e njësisë bazë, si dhe me përfaqësuesen e zyrës së burimeve njerëzore, rezulton se njësia bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm. Përgjegjësi i departamentit rezulton anëtar i komisionit të rekrutimit, të personelit të ri akademik, referuar praktikave të rekrutimit të konsultuara nga GVJ gjatë vizitës në institucion. Departamenti propozon profilin e nevojshëm të kandidatit për plotësimin e vendit vakant, në përputhje me ngarkesën mësimore që duhet të plotësohet.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. UMSH organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.
2. Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.
3. Njësitë bazë dhe kryesore kryejnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Rregulloren për Organizimin dhe Punën e Fakultetit të Shkencave Ekonomike, si dhe në rregulloret e secilit departament. Drejtuesit e njësisë kryesore dhe njësisë bazë të Fakultetit të Shkencave Ekonomike kanë gradë shkencore Dr.

GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni, vizitat në institucion dhe informacionin shtesë të siguruar gjatë këtyre vizitave, konkludon se **standardet e kësaj fushe konsiderohen të plotësuara.**

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

GVJ referuar vizitës në institucion dhe të dhënave të siguruara nga RVB, konstatoi se ky fakultet ka në përbërje të tij, një personel akademik të përbërë nga 59 pedagogë, nga të cilët 39 personel akademik efektiv dhe 20 personel akademik me kontratë, ndër të cilët 14 anëtarë janë me tituj/ grada. Pra 23.7% e stafit të Fakultetit përgjegjës për PS MPMB, është me tituj dhe grada. [Tabela 2.1] Përsa i përket Departamenti të Ekonomisë, për vitin akademik 2017-2018 në përbërje të tij janë 18 pedagogë në 2017-2018, nga të cilët, 13 pedagogë, janë personel akademik efektiv dhe 5 pedagogë janë personel akademik joefektiv. Për sa i përket kualifikimit të stafit të departamentit, 4 anëtarë të personelit akademik efektiv, janë me tituj/grada për vitin 2017-2018, pra 30.7% e stafit akademik efektiv janë me tituj/grada, ndërsa 100% e stafit joefektiv është e kategorisë profesore [Tabela 2] Personeli administrativ, organizohet në nivel universiteti. Përzgjedhja e anëtarëve të personelit akademik, si dhe vlerësimi i performancës së tyre rregullohet me dispozitat ligjore në fuqi, me dispozitat përkatëse në Statutin e UMSH-së. Departamenti i Ekonomisë, pas një analize të kapaciteteve dhe ngarkesave, konstaton nevojën për personel të ri akademik dhe paraqet propozimin për rekrutim personeli akademik. Propozimi përmban profilin profesional të personelit akademik, që propozohet të rekrutohet, si dhe argumentimin e këtij propozimi, dhe në varësi të ngarkesës që pritet të mbulojë, nëse nevojitet pedagog i efektiv ose joefektiv. Ngarkesa mësimore e stafit të angazhuar në PS MBMP, për vitet akademike 2016-2017 dhe 2017-2018, paraqitet në intervalin 210-240 ore. [Dokumenti 21 dhe Dokumenti 22, vizita në institucion]

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Referuar Tabelës 3.2 dhe 3.3 në shtojcën bashkëlidhur, në PS MPMB, janë të angazhuar 13 pedagogë nga të cilët 11 pedagogë janë staf efektiv i UMSH, dhe 2 prej tyre janë staf joefektiv, për vitin akademik 2017-2018. Staf i efektiv i angazhuar, përbëhet nga 2 pedagogë të kategorisë profesorë, 7 anëtarë kanë gradën doktor, dhe 2 janë në proces doktorature. Staf i joefektiv i përket kategorisë profesor. Nga 13 pedagogë të angazhuar, 4 i përkasin kategorisë profesor, 7 kategorise doktor i shkencave dhe 2 nuk kanë tituj/grada.

- Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinator/ët e programit të studimit
Këshilli shkencor i PS MPMB, përbëhet nga 3 pedagogë, të kategorisë profesor. Kryetari i Këshillit shkencor është akademik. Të dhënat për Këshillin shkencor pasqyrohen në Tabelën 3.1 në shtojcën bashkëlidhur
- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Plotëso Tabelat në Aneks, të cilat mund të plotësohen edhe nga verifikimi i tabelave të paqyruara në RVB)

Referuar tabelave 3.2 dhe 3.3 bashkëlidhur këtij raporti, 84.6% e stafit të angazhuar në këtë program studimi, për vitin akademik 2017-2018 është staf efektiv. Staf i me tituj/grada përbën 84.6%. 69.2 % e stafit të angazhuar në këtë program, përbëhen nga staf efektiv me tituj/grada. Të dhënat e mësipërme i përkasin vitit akademik 2017-2018. Referuar **shtojcës 10**, nga dokumentat e arshivuara nga UMSH, rezulton se për vitin akademik 2016-2017, kanë qenë të angazhuar në këtë program studimi 11 pedagogë, nga të cilët 82% staf efektiv dhe 18% staf joefektiv. 91% e stafit akademik, mbajnë tituj ose grada. Staf i efektiv me tituj/grada përbën 72.7% të stafit të angazhuar në PS MPMB. Për vitin akademik 2015-2016 kanë qenë të angazhuar 11 pedagogë nga të cilët, 72.7 janë staf efektiv, ndërkohë 91% janë me tituj/grada. Për vitin akademik 2014-2015, janë angazhuar 12 pedagogë, ndër të cilët 58% kanë qenë staf efektiv, ndër të cilët janë 75% janë me tituj dhe grada. Për vitin akademik 2013-2014, janë angazhuar 11 pedagogë, ndër të cilët 45% kanë qenë staf efektiv, ndër të cilët janë 81% janë me tituj dhe grada. Për vitin akademik 2012-2013, janë angazhuar 10 pedagogë, ndër të cilët 50% kanë qenë staf efektiv, ndër të cilët janë 90% janë me tituj dhe grada. Këto analiza janë siguruar nga Dokumenti 10, në shtojcat e arkivuara dhe nga Dokumenti 14, i siguruar gjatë vizitës në institucion.

Përsa më sipër GVJ konstaton se për një periudhë 6 vjecare, stafi i angazhuar në këtë program është ka pësuar një rritje prej 15%, por vihet re një rritje konsistente e stafit akademik efektiv të angazhuar në PS MPMB. Kështu stafi efektiv në vitin akademik 2012-2013 përbën 50% të stafit të angazhuar, vitin akademik 2013-2014 kjo norme ka qenë 45 %, 2014-2015 ka qenë 58%, për 2015-2016 72.7 janë staf efektiv, për 2016-2017 82% janë staf efektiv, për 2017-2018 84% janë staf efektiv. Për tre vitet e fundit kjo normë është mbi 70%. Në lidhje me kualifikimin e stafit, stafi me tituj dhe grada për intervalin kohor 2012-2017, është 72%-91%. **[Dokumenti arshive 10; Dokumenti 14 nga vizita në institucion]**

- Të dhëna sipas moshës së personelit

Të dhëna për përbërjen moshore të stafit akademik, të përfshirë në PS MPMB, paraqiten në Tabelën 3.4 në shtojcë. Referuar tabelës 3.4.1 dhe 3.4.2, 46 % e stafit efektiv dhe 39% e gjithë stafit të angazhuar janë nën

moshën 55 vjec për vitin akademik 2017-2018. GVJ nuk konstatoi ndryshime nga të dhënat e deklaruara në RVB dhe atyre të siguruara gjatë vizitës në institucion për përbërjen e stafit.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

GVJ referuar dokumentacionit të arshivuar nga institucioni, informacionit të siguruar nga shqyrtimi i dosjeve të stafit, konstaton se punonjësit akademikë në UMSH, punësohen me kontrata me afate të pacaktuara ose të caktuara. Kontrata e punës përmban identitetin e palëve, vendin e punës, përshkrimin e përgjithshëm të punës, kohëzgjatjen e kontratës, kohëzgjatjen e pushimeve të paguara; afatin e njoftimit për zgjidhjen e kontratës, elementet përbërëse të pagës, kohën normale javore të punës. Kontrata shoqërohet me anekse përkatëse për ngarkesën mësimore, punën shkencore, dokumentacionin, etj. [Arshiva Dokumenti 9. Model Kontrate pune]

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>GVJ, bazuar mbi RVB, takimet me stafin akademik të programit dhe nga informacioni i siguruar gjatë vizitës në institucion vëren se, personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre</p> <p>Ky personel akademik angazhohet në përputhje me strategjinë për kërkim shkencor të institucionit. Përvec procesit mësimdhënies ata janë të angazhuar në përfshirjen në konferenca shkencore dhe në botime Referuar vizitës në institucion, GVJ konstatoi pasaktësi në mbajtjen e rregjistrave të studentëve të PS MPMB, aktivitete këto që realizohen nga stafi administrativ. Për të rritur efektivitetin e këtij stafi, por dhe për të përmbushur detyrimet që burojnë nga kontrata e punës, GVJ sugjeron trajnime të vazhdueshme dhe mbikëqyrje të këtij stafi për përmbushjen e detyrimeve të tij.</p>
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Referuar RVB, takimeve me drejtues të njësisë bazë dhe me stafin e programit, personeli akademik angazhohet në nivel departamenti për diskutimin dhe përmirësimin e syllabuseve të lëndëve dhe raporteve të lëndëve në programet e departamentit</p> <p>Referuar takimit me përfaqësues së zyrës së burimeve njerëzore dhe me drejtues të njësisë bazë, si dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në institucion, procedura e rekrutimit për personelin e ri mbështetet në aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe në dispozitat e akteve rregullative të UMSH [Dokumenti 4, vizita në institucion]</p> <p>Departamenti është njësi prej nga fillon përcaktimi i ngarkesës mësimore për punonjësit akademikë, konform ligjit për arsimin e lartë. Referuar takimeve</p>

	<p>me anëtarë të stafit akademik, drejtuesin e njësisë bazë dhe informacionit të siguruar, ngarkesa e stafit akademik të PS MPMB është nga 210-240 ore faktike. Shpërndarja e lëndëve përputhet me profilin dhe ekspertizën e stafit akademik, referuar dokumentacionit të dorëzuar nga institucioni për stafin.</p> <p>[Dokumenti 21, 22, vizita në institucion]</p>
<p>.Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Procedura e rekrutimit të personelit përcaktohet në Statutin dhe Rregulloren organizative të UMSH. UMSH, në bazë të nevojave të njësisë bazë për personel të ri akademik, dhe me propozim nga dekani, planifikon, shpall dhe organizon procedurën e konkurrimit të hapur, transparente dhe objektive. Në PS MPMB, në të gjitha profilet, personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në funksion të realizimit të programit është mbi 70%. Kjo normë është në intervalin 70%-90%, në profile të ndryshme të MPMB, përgjatë periudhës 2012-2018. [Dokumenti 7, Dokumenti 10, arshiva]</p> <p>GVJ konstaton se UMSH ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit. Gjatë vizitës në institucion GVJ identifikoi praktika të ndryshme të vlerësimit të personelit, si vlerësimi nga studentët dhe vetëvlerësimi si dhe vlerësimi nga supervizori. [Dokumenti 2, Dokumenti 10, vizita në institucion]</p> <p>Forma të tilla vlerësimi konstatohen të depozituara në dosjet personale të stafit, pranë burimeve njerëzore. Bazuar në aktet rregullative të UMSH, institucioni disponon një bazë të dhënash, për sa i përket njoftimeve të vendeve vakante, kritereve dhe raporteve/procedurave të rekrutimit të personelit. Kjo bazë të dhënash administrohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore.</p>
<p>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</p>	
<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>GVJ konstaton se përgjegjësi i këtij programi studimi ka gradë shkencore “Doktor i Shkencave” dhe ka përvojë akademike dhe profesionale shumëvjeçare</p> <p>Referuar informacionit të siguruar nga RVB dhe vizita në institucion, për 2017-2018, rezulton se 13 titullarë të lëndëve në PS MPMB, me profile, ndër të cilët 11 janë me tituj/grada dhe 2 janë në proces doktorature</p> <p>Drejtesit në strukturën organizative, Rektori, Zv/Rektori, Dekani, Përgjegjësi i Departamentit të PS MPMB, janë të punësuar me kohë të plotë në UMSH. [Dokumenti 11 arshivë, Dokumenti 16, 17, vizita në institucion]</p> <p>Referuar RVB dhe vizitës në institucion, UMSH, siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale. Për vitin akademik 2017-2018, janë 3 pedagogë që mbulojnë udhëheqjen e praktikave. Nr i praktikantëve është nga 10-15 për cdo pedagog udhëheqës. [Dokumenti 5, vizita në institucion]</p>

Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Referuar takimeve me pedagogët e këtij programi dhe me studentët, rezulton se çdo student që ndjek këtë program studimi, i caktohet një udhëheqës për temën e diplomës që duhet të përgatisë në përfundim të studimeve të këtij cikli.</p> <p>GVJ referuar informacionit të siguruar nga vizita në institucion për shpërndarjen e temave të diplomës, konstaton se udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”.</p> <p>Referuar numrit të stafit akademik dhe numrit të vogël të studentëve që ndjekin këtë program studimi, konstatohet se është respektuar kriteri jo më shumë se dhjetë studentë/një pedagog udhëheqës.</p>
Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Referuar të dhënave për stafin të vendosura në dispozicion nga institucioni, takimeve me stafin dhe me studentet, pedagogët udhëheqës të diplomës, janë njohës të mirë të fushës dhe me eksperiencë akademike.</p> <p>[Dokumenti 5, arshiva]</p> <p>Udhëheqësit kanë njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza. [Dokumenti 5, arshive, Dokumenti 26, vizita në institucion]</p> <p>Mbështetur në takimet me drejtues të njësisë bazë dhe të studentëve të PS MPMB si dhe RVB, departamenti bën të njohura për studentët temat ose fushat e studimit për përgatitjen e punimeve të diplomave. Studentët paraqesin kërkesat e tyre në departament për temën e zgjedhur dhe preferencën për udhëheqës. Departamenti i shqyrton ato dhe cakton udhëheqësit nisur nga specialiteti dhe kualifikimi i personelit akademik të tij.</p> <p>[Dokumenti 26, vizita në institucion]</p>
Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Mbështetur në Statutin e UMSH, rregulloren e UMSH dhe rregulloren e PS MPMB, personeli ndihmës mësimor angazhohet në realizimin e seancave mësimore, në realizimin me sukses të punimeve në kuadrin e diplomave universitare e tezave dhe në mirëmbajtjen e laboratorëve dhe mjediseve universitare.</p> <p>Stafi akademik i UMSH është i përfshirë në realizimin e ngarkesën orë mësimore, orë konsultimi, kërkim shkencor, tutoriatin, praktikat profesionale, udhëheqjen</p>

	e temave të diplomave apo komisione në provime formimi si dhe realizimin e detyrave administrative sipas kushteve të kontratës së punës, duke i shërbyer objektivave të programit. [Dokumenti 9, arshivë]
Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Përcaktimi i ngarkesës mësimore në UMSH bazohet në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. RVJ konstaton se ngarkesat mësimore gjenden të pasqyruara në planin mësimor për çdo vit akademik, me pedagogët përkatës për çdo lëndë. [Dokumenti 7, arshive]</p> <p>Referuar informacionit të siguruar nga vizita në institucion, takimeve me drejtues të njësisë bazë dhe stafin akademik rezultojnë se ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në PS MPMB, vlerësohen me orë mësimore. Kjo ngarkesë varion nga 210-240 orë mësimore në auditor. [Dokumenti 21, 22, vizita në institucion]</p>
Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>GVJ konstaton se UMSH disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë PS MPMB dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit. [Dokumenti 5, arshive]</p> <p>GVJ konstaton se UMSH disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, ndërsa personeli administrativ është në nivel institucioni [Dokumenti 7, arshive, Dokumenti 21,22 vizita në institucion]</p> <p>UMSH ka të përcaktuara kriteret për rekrutimin e stafit, kriteret këto që publikohen në mediat e shkruara apo në web sitin e institucionit</p>
Konkluzionet e vlerësimit:	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Personeli akademik, angazhohen për përmbushjen e objektivave të PS MPMB, me profile. 2. Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit. UMSH ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit. 3. Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza. 4. Departamenti në varësi të nevojës parashtron edhe kriteret për rekrutimet e reja që janë në varësi të lëndës për të cilën ka lindur nevoja. Personeli akademik është me kohë të plotë dhe të pjesshme. Procedura e rekrutimit kryhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Njoftimet për vënde vakante bëhen në web të institucionit, në media vizive dhe ne kompani rekrutuese. 	
Standardet e kësaj fushe janë plotësuar	

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

GVJ referuar RVB, vizitës në institucion si dhe identifikimit të infrastrukturës që është në dispozicion të PS MPMB, konstaton se Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” e zhvillon aktivitetin në një vend të përqëndruar, gjë që ndihmon përdorimin me efektivitet maksimal të ambienteve, stafit pedagogjik, atij mbështetës, administrativ e të shërbimeve.

Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë" ushtron aktivitetin e tij në një sipërfaqe prej 3860 m², duke e shtrirë mësimin nga e hëna deri të shtunën dhe organizuar atë çdo ditë në tre fasha orare duke filluar nga ora 8.30 – 21:00. UMSH pozicionohet në një zonë universitare që i jep mundësi studentëve të ndërveprojnë e komunikojnë edhe me studentë të tjerë si në universitete publike dhe jo-publike si dhe në programe të ndryshme. Godina karakterizohet nga ndriçimi natyral dhe komoditeti e lehtësia e lëvizjes në të gjitha ambientet duke përfshirë rampat dhe ashensorët që i japin mundësi të gjithë personave me aftësi të kufizuara të angazhohen në të gjithë aktivitetet akademike dhe të tjera. Godina është e të njëjtit standard në të gjithë shtrirjen e saj e pajisur me mjete për ndriçim alternativ, rezerva të konsiderueshme uji, sistem kondicionimi modern gjatë gjithë vitit i shtrirë në të gjithë ambientet, internet, vende çlodhjeje e qëndrimi, projektorë, sistem mbrojtjeje nga zjarri, CCTV, shërbim, ndihmë të shpejtë dhe ashensorë. Godina është e pajisur dhe me shkallë emergjence të cilat ndodhen në mes të korridorit të njesisë së pozicionuar në katin e dytë. Godina ka gjashtë amfiteatro, salla të medha mësimore me kapacitet prej 100 -120 vende të ulura me sipërfaqe prej 100-110 metër katror secila, pesëmbëdhjetë salla e seminareve me kapacitet prej 30-45 vende ulëse me sipërfaqe prej mëse 35-55 metër katror secila. Në funksion të studentëve dhe stafit në të gjithë hapësirat e UMSH, është instaluar interneti wireless me shërbim interneti 24 orë.

GVJ nga vizita në institucion konstaton se, ambientet e bibliotekave janë 2 hapësira që variojnë nga 20 - 90 m², të pajisura me raftë për revista e libra, për fakultet dhe programe mësimore të dukshme dhe funksionale për studentët dhe personelin akademik. Sallat e leximit janë të pajisur me poste leximi dhe studimi dhe me disa PC me shërbim interneti për punën kërkimore të studentëve. Biblioteka e UMSH, është e pajisur me literaturë të fushave të ndryshme, me tekste universitare, revista shkencore si dhe materiale të tjera shkencore, të ndara sipas drejtimeve: Ekonomi; Financë, Kontabilitet, Banka, Makro-Mikro, Statistikë, Marketing, Biznes, Menaxhim, Turizëm; Pedagogji; Letërsi, Fjalor, Anglisht, Pedagogji; Biznes; Organizim, Taksa, Transaksione, Pasuri e Paluajtëshme, Kredi-Debi, Marrëdhënie e Punësimit. Biblioteka Online e Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë" krijon mundësinë e aksesit në një fond të pasur të literaturës on-line

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit

Të dhëna të detajuara për mjediset në dispozicion të programeve të studimit që UMSH ka, paraqiten në tabelën 4.1, në shtojcën bashkëlidhur si dhe në Dokumentin 17 arshivë, "Relacion Verifikim Godine". Mjediset janë në nivel institucioni dhe referuar tabelës 4.1, UMSH dëshmon se ka infrastrukturën e duhur në dispozicion të programeve të studimit, të përbërë nga 6 amfiteatro, 15 klasa seminaresh, sallë për njësinë bazë që mbulon këtë program studimesh, zyrë për përgjegjësin e njesisë bazë, për sekretarinë mësimore etj. Të gjitha klasat mësimore janë pajisur me pajisjet audio vizive të nevojshme për zhvillimin normal të procesit mësimor. Ato janë të pajisura me videoprojektorë, dhe me sistem kondicionimi. GVJ vlerëson se kjo infrastrukturë, është e përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor dhe të aktiviteteve të tjera mbështetëse për PS MPMB.

Mjediset për stafin:

Referuar RVB dhe vizitës në ambientet e institucionit, rezulton se:

- Zyra për dekanin/zv.dekanin/kancelarine janë 7, sipërfaqja totale 150 m².
- Zyra për sekretarinë mesimore janë 3 me sipërfaqe 48 m².
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore janë 8 me sipërfaqja totale 262.6 m²

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vezhgam i ambjenteve si biblioteka, sallat e seminareve leksioneve, zyrat e administrates.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>GVJ referuar RVB dhe Dokumentit 17 arshivë, si dhe identifikimit të infrastrukturës që është në dispozicion të PS MPMB, gjatë vizitës në institucion konstaton se UMSH, e zhvillon aktivitetin në një vend të përqëndruar, e cila ndihmon përdorimin me efektivitet të infrastrukturës, stafit akademik dhe atij mbështetës e administrativ</p> <p>UMSH e ushtron aktivitetin mësimor në një godinë të marrë me qera, e cila është në shërbim të institucionit për jo më pak se 10 vjet, sipas dokumentit të kontratës së qirasë. [Dokumentit 15 arshivë]</p>
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>GVJ referuar informacionit të siguruar gjatë vizitës në UMSH, takimeve me drejtues të njësisë bazë, përfaqësues të zyrës kërkimit shkencor, konstaton se institucioni, siguron tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse në dispozicion të PS MPMB. GVJ sugjeron që kjo literaturë të përditësohet me botimet e fundit të fushave respektive, referuar këtu literaturës së cituar në programet e lëndëve. [Dokumenti 6, arshivë]</p> <p>GVJ, konstaton nga informacioni, i marrë gjatë vizitës në institucion, se biblioteka e UMSH, ka literaturë që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës, por GVJ sugjeron shtimin e zërave të bibliotekës me literaturë cilësore dhe të azhurnuar të viteve të fundit, në përputhje me lëndët që PS MPMB me profile, përmban.</p> <p>Referuar Dokumentit 13 të siguruar pas vizitës në institucion, GVJ konstaton se në bibliotekën e UMSH, gjenden botime periodike dhe librari elektronike si www.questia.com të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme, për realizimin e programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës.</p> <p>GVJ, konstaton nga informacioni, i marrë gjatë vizitës në institucion, takimeve me përgjegjësen e njësisë bazë dhe GVB, se përgjegjësi i PS MPMB dhe pedagogët, janë të angazhuar për pajisjen e bibliotekës me tekstet mësimore dhe literaturës së azhurnuar. Dokumenti 19, i siguruar nga vizita në institucion, paraqet një plan për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët.</p> <p>Referuar GVB, informacionit të siguruar nga studentët dhe nga personeli i bibliotekës gjatë vizitës në institucion, biblioteka, si njësi ndihmëse, i shërben aktivitetit mësimor dhe atij kërkimor në UMSH, në përshtatje me oraret dhe nevojat e studentëve.</p>

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>GVJ referuar Dokumentit 17 arshive, vizitës në institucion dhe RVB, vlerëson se UMSH dëshmon se ka infrastrukturën e duhur në dispozicion të programeve të studimit, të përbërë nga 6 amfiteatro, 15 klasa seminaresh, sallë për njësinë bazë, zyrë për përgjegjëgjësin e njësisë bazë, për sekretarinë mësimore etj.</p> <p>Klasat mësimore janë pajisur me pajisjet audio vizive të nevojshme për zhvillimin normal të procesit mësimor. Ato janë të pajisura me videoprojektorë, dhe me sistem kondicionimi. GVJ vlerëson se kjo infrastrukturë, është e përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor dhe të aktiviteteve të tjera mbështetëse për PS MPMB. [Dokumentit 17 arshive]</p> <p>UMSH disponon tre laboratorë informatikë Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të PS MPMB</p> <p>PS MPMB me profile, nuk parashikon në kurrikulën e saj, zhvillimin e praktikave laboratorike</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>GVJ mbështetur në dokumentacionin e arshivuar, dokumentacionin e siguruar gjatë vizitës në institucion, vlerëson se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. UMSH siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimit MPMB, me profile. UMSH vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij. 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore. <p>GVJ sugjeron shtimin e zërave të bibliotekës me literaturë cilësore dhe të azhurnuar të viteve të fundit, në përputhje me lëndët që PS MPMB me profile, përmban</p> <p>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni, vizitat në institucion dhe informacionin shtesë të siguruar gjatë këtyre vizitave, konkludon se standardet e kësaj fushe janë plotësuar</p>	

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Referuar informacionit shtesë të siguruar nga vizita në institucion dhe nga RVB, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë është projekt i OJF “Qendra Mesdheu”. Kjo OJF është regjistruar me Vendim Nr. 411 datë 06.07.2007 të Gjykatës së Rrethit Tiranë si person juridik me objekt të aktivitetit “shërbimet në fushën e arsimit të lartë privat dhe kërkimit shkencor” si dhe i regjistruar në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. (Ligji Nr. 8788, “Për Organizatat Jo Fitimprurëse” dhe Ligji nr. 8789, “Për Regjistrimin e Organizatave Jo Fitimprurëse”). Duke ju referuar nenit 24 të Statutit dhe nenit 15 të Rregullores Organizative të UMSH, Bordi i Administrimit është organi më i lartë Kolegjial Administrativ i cili siguron përmbushjen e misionit, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij. Bordi i “Qendra Mesdheu” është autoriteti i cili emëron anëtarët e Bordit të Administrimit. Rezultatet dhe financimi, menaxhimi dhe administrimi i UMSH pasqyrohen në Pasqyrat Financiare të tij. Institucioni ofron shërbime duke u fokusuar në misionin e tij dhe mban kontabilitet të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi:

Referuar tabelës 5.1 në shtojcën bashkëlidhur, të ardhurat në vitet nga 2012-2016 e UMSH, janë siguruar 100% nga të ardhurat nga tarifat e shkollimit si dhe nga aktivitetet tregëtare. Për vitin 2017, të ardhurat janë siguruar nga tarifat e shkollimit si dhe nga aktivitetet tregëtare si dhe grantet për kërkime dhe kontratat. Për vitin 2017, të ardhurat nga tarifat e shkollimit përbëjnë 98.3%, të ardhurat nga grantet për kërkime dhe kontratat përbëjnë 0.53%, dhe të ardhurat nga aktivitetet tregëtare 1.12%.

- Grantet për kërkim përbëjnë 0.53% të të ardhurave për vitin 2017, në vitet 2012-2016, nuk ka pasur grante
- Konsulencat, shërbimet, nuk kanë siguruar të ardhura gjatë 2012-2017
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit kanë siguruar 98.3 % të ardhurave gjatë 2017
- Sponsorizimet nuk kanë siguruar të ardhura gjatë 2012-2017
- Shërbimet trainuese nuk kanë siguruar të ardhura gjatë 2012-2017
- Donacionet, aktivitetet siguruese etj nuk kanë siguruar të ardhura gjatë 2012-2017
- Aktivitetet tregëtare kanë siguruar 1.12 % të ardhurave gjatë 2017

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përçindje)

Të dhënat për kostot e studimit, paraqiten në Tabelën 5.2, në shtojce.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>Intitucioni auditohet çdo vit nga një kompani e certifikuar auditimi e jashtme, ku miratohet pozicioni financiar dhe përputhshmëria ligjore e shpenzimeve dhe burimeve të krijuara. Raporti i auditit të jashtëm fokusohet në kërkesat ligjore mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare. Ai jep opinionin e tij të pavarur mbi situatën financiare të Qendrës Mesdheu. Në këtë raport përcaktohen burimet financiare dhe drejtimet e OJF-s. GVJ iu vendos në dispozicion opinion i audituesit të pavarur [Dokument 20]</p> <p>Qendra Mesdheu, kryen auditimin e brendshëm, i cili nis me raportimet që lidhen me situatën financiare dhe kontrollin e përdorimit të burimeve, duke përpunuar një program të miratuar nga Bordi i Administrimit. Në mënyrë periodike, Bordi kërkon në bazë të statutit raporte për realizimin e buxheteve.</p>

	Bordi kërkon nga auditimi i brendshëm të raportoje për eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve, përmirësimin e stafit akademik, investimin në përmirësime infrastrukturore etj.
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>GVJ, konstaton se në RVB, paraqiten numri i studentëve për 7 vitet, totali i financimeve si dhe kostot/student. Këto kosto paraqiten në tabelën 5.2 në shtojcën bashkëlidhur</p> <p>UMSH është projekt i OJF Qendra Mesdheu dhe në bazë të statutit, harton raporte të përvitshme financiare të detajuara të cilat i paraqiten Bordit në çdo vit, duke siguruar në këtë mënyrë qëndrueshmërinë financiare në gjenerimin e të ardhurave dhe vijueshmërisë së aktivitetit.</p>
Konkluzionet e vlerësimit:	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Institucioni ka dorëzuar në RVB tabelën e shpenzimeve dhe të ardhurave. Burimi kryesor i të ardhurave janë tarifat e studentëve dhe aktiviteti tregtar. 2. Institucioni ka aplikuar në disa projekte në mënyrë që të sigurojë një burim tjetër të ardhurash. 3. UMSH bën një auditim të përvitshëm të jashtëm dhe të brendshëm të situatës financiare, ku pasqyrohen burimet e financimit si dhe shpenzimet. 4. UMSH harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve. <p>GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni, vizitat në institucion dhe RVB, konkludon se standardet e kësaj fushe plotësohen</p>	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Njësia e sigurimit të brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NJSBCZHK) pranë UMSH, e ka nisur punën që me krijimin e institucionit, fillimisht në formën e grupeve ad hoc, dhe nga Janari 2011 në formën e një njësie të përhershme në strukturën organizative të institucionit, si Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Komisioni vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore, administrative e financiare të UMSH dhe ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Standardet për sigurimin e cilësisë të institucionit hartohen në përputhje me Manualin e Sigurimit të Brendshëm dhe Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. Manuali i Sigurimit të Brendshëm është i miratuar nga Senati Akademik. Veprimtaria e NJSBCZHK është e rregulluar sipas Manualit të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBCZHK) dhe rregullores së NJSBCZHK, të miratuar në 2017. NJSBCZHK përbëhet nga 7 anëtarë, të cilët janë janë në këtë detyrë prej nëntorit të 2017. NJSBCZHK ka në përbërje edhe përfaqësues të studentëve dhe nga stafi administrativ.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

Referuar takimeve me përfaqësues të NJSBCZHK dhe RVB, rezulton se NJSBCZHK kryen anketimet para sezoneve të provimeve dhe në të marrin pjesë studentët që janë prezent dhe dëshirojnë të plotësojnë anketën. Ky numër zakonisht nuk është më i vogël se 60% të studentëve aktivë për vitin akademik. Anketimet kryhen 2 herë në vit në të gjitha lëndët që zhvillohen gjatë vitit akademik, përkatësisht semestrave mësimore. Përpunimi i anketimeve realizohet nga NJSBCZHK e cila përpunon rreth 25% të anketave të plotësuara të zgjedhura në mënyrë rastësore. Për lëndët të cilat ndiqen nga rreth 30 studentë, përpunohen të gjitha anketat e plotësuara. Për rastet kur numri i anketave të plotësuara është më i vogël se 25%, anketa nuk merret në konsideratë për tu përpunuar. Përpunimi i anketimeve realizohet nga NJSBCZHK e cila përpunon rreth 25% të anketave të plotësuara të zgjedhura në mënyrë rastësore. Për lëndët të cilat ndiqen nga rreth 30 studentë, përpunohen të gjitha anketat e plotësuara. Për rastet kur numri i anketave të plotësuara është më i vogël se 25%, anketa nuk merret në konsideratë për tu përpunuar. Për secilin nga proceset akademike që vlerësohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre NJSBCZHK raporton pranë rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve, rekomandon detyra, zbatimi i të cilave ndiqet nga ana e strukturave drejtuese dhe vetë NJSBCZHK. Këto rekomandime kanë qënë një burim i rëndësishëm për të nxjerrë konkluzione mbi cilësinë e punës së secilit, në disa raste janë shoqëruar edhe me marrjen e masave konkrete ndaj pedagogëve të ndryshëm.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjate vizitës në institucion, GVJ-se në lidhje me sigurimin e brendshëm të cilësisë, iu vendosen në dispozicion dokumentat e kërkuar, te cilët u shqyrtuan në funksion të konkluzioneve të nxjerra për këtë rubrikë [Dokumenti 2 “Formular i vleresimit të pedagogëve.pdf”, Dokumenti 7 “Relacion mbi rezultatet e anketimit studentor 2017”, Dokumenti 10 “Vleresim Performances të Stafit”, Vizita në institucion]

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj); Dëgjime në auditor; Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë; 	<p>Referuar vizitës në institucion dhe takimeve me përfaqësues të NJSBCZHK, dokumentacionit të siguruar nga institucioni, GVJ konstaton se UMSH përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve [Dokumenti 2, Dokumenti 10]</p> <p>Nga dokumentacioni i siguruar, mbas vizitës në institucion, GVJ konstaton se UMSH e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë. [Dokumenti 7 “Relacion mbi rezultatet e anketimit studentor 2017”]</p> <p>UMSH rezultatet e vlerësimit i vë në dispozicion të drejtuesve të institucionit, atyre të fakulteteve si dhe reflektohen në vlerësimin e performancës së çdo pedagogu në përfundim të vitit akademik.</p> <p>Nga vizita inspektuese në UMSH, rezulton se institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta, sic janë pyetësorë me student, për vlerësimin e mësimdhënies, kurrikulës, dëgjime në auditor, rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pike etj. [Dokumenti 2,</p>

<p>d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</p> <p>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</p> <p>h. Etj.</p>	<p>Dokumenti 10 vizita ne institucion, Dokumenti 20 arshive]</p>
<p>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>GVJ konstatoi se UMSH përgatit dhe shpërndan në formën e një raporti vlerësimet periodike mbi cilësinë, i cili u vihet në dispozicion strukturave drejtuese por edhe pedagogëve, sikurse dhe aktorëve të tjerë të interesuar. [Dokumenti 7 “Relacion mbi rezultatet e anketimit studentor 2017”]</p> <p>Sipas informacionit të siguruar nga drejtuesja e NJSBC, manuali i NJSBC dhe rregullorja e saj publikohen në webin e UMSH</p>
<p>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Referuar RVB, takimeve me NJSBCZHK dhe drejtues rezultun se UMSH, analizon mbi bazë fakulteti dhe departamenti, ecurinë e programeve të studimeve, duke përfshirë në to mendimin e përfaqësuesve të tregut të punës dhe opinionin e studentëve.</p> <p>Bazuar në feedback-un e marrë nga studentët, nëpërmjet pyetësorëve dhe fokus grupeve por dhe aktorëve të tjerë, UMSH programon politika dhe ndërmerr masa për zhvillimin e mëtejshëm të programeve të studimit</p>
<p>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>UMSH ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar dhe riakredituar në nivel institucional. PS MPMB janë akredituar nga institucionet përgjegjëse në vitin 2012.</p> <p>UMSH përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë si pyetësorët e studentëve, fokus grupet, dëgjuesat në auditor etj.</p> <p>GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit konstaton se UMSH, harton politika mbë shtetur në strategjinë e programit, ku në fokus është cilësia, në manualin e sigurimit të cilësisë dhe rregulloren e NJSBCZHK</p> <p>Instrumentat e përdorur nga NJSBCZHK e UMSH, janë mekanizma formalë. GVJ sugjeron që UMSH të konsolidojë përdorimin e këtyre mekanizmave si dhe ti diversifikojë këto mekanizma në të ardhmen</p> <p>Nga takimet me drejtues të NJSBCZHK drejtuese e njësisë bazë dhe me përfaqësues të zyrës së kërkimit shkencor, rezultun se institucioni synon ndërgjegjësimin e vazhdueshëm të personelit përmes një larmie formash,</p>

nga trajnimi deri te rifreskimi i njohurive mbi standardet dhe kërkesat e veçanta për cilësi. Po ashtu, studentët njihen me kërkesat mbi cilësinë në UMSH me fillimin e vitit akademik dhe gjatë vitit në takime të veçanta me drejtuesit e institucionit, pedagogët, etj.
GVJ sugjeron publikimin e strategjisë dhe politikave për përmirësimin e cilësisë nëpërmjet broshurave, buletineve apo prezantimeve video, në faqen e internetit të UMSH

Konkluzionet e vlerësimit:

1. UMSH përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.
2. UMSH publikon informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.
3. UMSH kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.
4. UMSH garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.
5. Institucioni ka të hartuar në mënyrë të qartë politikën e procedurës së vlerësimit periodik. NJSBCZHK është organi kryesor që realizon anketimet për matjen e performancës së pedagogëve në procesin e mësimor, për vlerësimin e infrastrukturës mësimore, për vlerësimin e punës me studentët dhe të sekretarisë mësimore.

Nga sa më sipër, standardet plotësohen.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Programi i studimit MP Adminitrim Biznes me profile, ofrohet nga UMSH për të gjithë studentët që zotërojnë diplomë të ciklit të parë Bachelor. Njohuritë e ofruara përkohë me njohuritë e fituara nga studentet në aspektin teorik dhe praktik, gjatë studimeve të programit Bachelor. Programi Master Profesional i orienton studentët në tregun e punës.

Programi i studimit në vetëvete, ka si qëllim ti pajisë studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale me qëllim që tu shërbejnë në tregun e punës por edhe në të ardhmen duke qenë të aftë të zgjerojnë njohuritë e marra si gjatë zhvillimit të programit edhe në vazhdimësi. Pas përfundimit me sukses të programit Master Profesional, studentet janë të aftë në tregun e punës.

Programi i studimit është hartuar në përputhje me planin e tij mësimor. Studimet në këtë cikël realizohen me 60 kredite dhe zgjatja normale e tyre është 1 (një) vit. Në përfundim të programit të studimeve të ciklit të dytë studenti pajiset me diplomë "Master profesional". Në këtë program zhvillohen shtatë lëndë mësimore dhe gjatë semestrit të dytë studentët zhvillojnë edhe praktikën mësimore dhe përgatisin punimin e diplomës, ose provimin përfundimtar. Organizimi i vitit mësimor zhvillohet konform akteve dhe rregullave në fuqi, që përcaktojnë ngarkesën në auditorë dhe jashtë tyre, sipas krediteve përkatëse të çdo lënde. Plani mësimor për këtë program siguron një shpërndarje të balancuar të ngarkesës mësimore ndërmjet semestrave.

Programi i studimit MP Menaxhim Biznesi është ndërtuar në përshtatje me kërkesat e Kartës së Bolonjës. Programi është ndërtuar në mënyrë të tillë që të përgatisë specialistë në Menaxhim Shendetit, Menaxhim Arsimit, Pasuri e paluajtshme, Menaxhim Turizmi, Menaxhim Arti. Ky program është përshtatur me aktualitetin shqiptar por pa pasur një studim mbi nevojat e tregut të punës. Ky program i jep njohuri të mjaftueshme studentëve për të qenë të gatshëm për tu ofruar në tregun e punës por gjithashtu i jep mundësi atyre të vazhdojnë studimet e tyre në ciklin e tretë. Ky program studimi nuk ndjek një model apo shkollë të përcaktuar.

Për ndarjen e lëndëve/moduleve sipas veprimtarive formuese departamenti është bazuar në Udhëzimin Nr.15,

datë 04.04.2008 ‘Për organizimin e studimeve në IAL’ si dhe në Udhëzimin Nr.11, datë 28.02.2011 “Për procedurat dhe dokumentacionin për hapjen e një Institucioni Privat të Arsimit të Lartë, Programeve të reja të studimit universitar në ciklin e parë dhe ciklin e dytë, programeve të studimit jo universitare, të natyrës profesionale, si dhe procedurat për pezullimin dhe revokimin e licencës”. **Duhet të theksojmë se për ndarjen e lëndëve/moduleve sipas veprimtarive formuese departamenti duhet të mbështetet në VKM nr 41, dt 24.01.2018, ku programet MP organizohen në 5 disiplina. Kjo mbetet si objektivi për tu realizuar në vitet e ardhshme.**

Programi MP organizohet në 6 kategori disiplina (duhet të kemi parasysh që VKM nr. 41 dt 24.01.2018 bën një organizim në 5 kategori). Disiplinat mësimore dhe aktivitetet e tjera formuese të programit janë të organizuara në këto kategori: **Tabela 7**

- Organizimi i çdo programi studimi (vite, semestra, javë etj.)
 - 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
 - 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor
 - 1 ECTS 25 orë mësimore punë të studentit
 - 1 orë mësimore 60'

- Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit për:

- Leksionet 12 orë në auditor dhe 13 orë punë e pavarur e studentit
- Seminare/Ushtime 11 orë në auditor dhe 14 orë punë e pavarur e studentit
- Seminare/Detyra 10 orë në auditor dhe 15 orë punë e pavarur e studentit
- Praktikën Profesionale 21 orë në auditor dhe 4 orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar 1 orë në auditor dhe 24 orë punë e pavarur e studentit

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi i studimit MP, është hapur në bazë të Urdhërit nr. 482 datë 03.10.2011 të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës dhe Akredituar me Urdhërin nr. 291 datë 11.07.2012.

Programi MP i orienton studentët për një edukim cilësor të qëndrueshëm me anë të mësimdhënies, kontributit në kërkim shkencor të thelluar, përdorimit të arritjeve më të mira dijes dhe të shkencës, si dhe partneriteteve me tregun e punës dhe atyre ndërkombëtare, si dhe i aftëson ata për të zotëruar dije dhe aftësi të mirëfillta profesionale në fushën e menaxhimit. Programi i studimit ka si qëllim formimin e ekspertëve dhe specialistëve të mirëfilltë në fushën e shëndetit, arsimit, artit, pasurive të paluajtshme etj.

Tabela 8. Plani mësimor sipas veprimtarive (shtojca)

- Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë. Shenim: Në planin mësimor të programit Menaxhim Biznesi me profil Turizëm janë bërë ndryshime vetëm në emërtimin e dy lëndëve. Nuk ka ndryshuar numri i krediteve (ECTS), as raporti leksion/seminar dhe as koha e zhvillimit të lëndëve.

Lënda 1 ishte “Promocioni” - Lënda 1 u ndryshua “Promocioni në turizëm”

Lënda 2 ishte “Sigurimi dhe higjiena në ushqim » -Lënda 2 u ndryshua “Sigurimi dhe higjiena në ushqim – sistemet hotelerike dhe restorantaria »

- Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës Tabelat 9.

- Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Institucioni ka dorëzuar vetëm syllabuset për vitin 2012-2013. Kjo tregon që gjatë kësaj periudhe nuk ka asnjë ndryshim në syllabuset e lëndëve. Në pjesën e parë, të syllabusit jepet një përshkrim i përgjithshëm i lëndës. Detajohet ngarkesa në kredite si dhe përcaktimi nëse lënda është e detyrueshme apo lëndë me zgjedhje. Nëse do të bëjmë një renditje të elementeve bazë të syllabuse, do të vijnë objektivat e lëndës. Objektivat e lëndës do të shpjegojnë mënyrën sesi studentët do të pajisen me njohuritë e duhura për atë çfarë lënda ka në përmbajtjen e saj. Më pas paraqiten format dhe metodat e mësimdhënies, duke filluar me leksionet në auditor, auditoret e hapura me të ftuar nga personalitete dhe ekspert te fushave të caktura dhe duke vazhduar me diskutime, debate gjatë seminareve të programuara. Ngarkesa mësimore është pjesë detyruese e komponenteve të syllabusit, në të cilën realizohet përputhja e orëve mësimore me ato të përcaktuara në planet mësimore. Detyrimet për studentin janë gjithashtu të përcaktuara në syllabus me qëllimin, që të bëhet e mundur informimi i studentëve mbi detyrimet që ata kanë kundrejt lëndës. Forma e vlerësimit të studentëve do të jetë e unifikuar për të gjitha lëndët, duke e ndarë vlerësimin në përqindje dhe konkretisht 60% të lëndës e përbën nota përfundimtare, dhe 40% vlerësimet e ndërmjetme. Një ndarje e tillë është menduar të realizohet me synimin që studentët të jenë prezentë gjatë gjithë orëve në auditor, si dhe orëve jashtë tij të mendojnë mbi realizimin e detyrave të ngarkuara nga pedagogu i lëndës. **Syllabuset janë të papërshtatura me shtojcën 2 të VKM 41 dt 24.01.2018, madje ato nuk kanë pësuar asnjë ndryshim as në formë as në përmbajtje që nga momenti i hapjes së PS për më tepër që në gjithë këto vite literatura ka pësuar ndryshime.**

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi i studimit MP, është hapur në bazë të Urdhërit nr. 482 datë 03.10.2011 të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës dhe Akredituar me Urdhërin nr. 291 datë 11.07.2012. Mbështetur në ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ky institucion ofron programe studimi bazuar në kërkesat e sistemit të Bolonjës sipas legjislacionit shqiptar. Programi i studimit MP Menaxhim Biznes me profile ka filluar në vitin 2011.</p> <p>Institucioni është i akredituar institucionalisht</p> <p>Ky PS ka 60 kredite në total dhe kohezgjatje 1 vit/2 semestra.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinar, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p>	<p>Programi MP i orienton studentët për një edukim cilësor të qëndrueshëm me anë të mësimdhënies, kontributit në kërkim shkencor të thelluar, përdorimit të arritjeve më të mira dijes dhe të shkencës.</p> <p>Nga vizita në institucion u vu re se programi i studimit ka si qëllim formimin e ekspertëve dhe specialistëve të mirëfilltë në fushën e menaxhimit të arsimit, të shëndetit artit etj.</p> <p>Programi i studimit në vetëvete, ka si qëllim t’i pajisë studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale me qëllim që tu shërbejnë në tregun e punës por edhe në të ardhmen duke qenë të aftë të zgjerojnë njohuritë e marra si gjatë zhvillimit të programit edhe në vazhdimësi.</p>

<p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionalë, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi PM ka qëllim të qartë në formimin e specialistëve në profilet përkatëse.</p>
Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshatje me nivelin e studimeve.	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodot e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Objektivat e programit të studimit MP përputhen me strategjitë e institucionit. Sipas RVB programi i studimit MP në veprimtarinë e tij paraqitet në përputhje me planin strategjik të zhvillimit institucional, kërkimit shkencor, bashkëpunimit dhe ndërkombëtarizmit 2012-2017.</p> <p>Programi i studimit MP ka si objektiv të zhvillojë dijet e mëtejshme të studentët që kanë formim të nivelit Bachelor. Programi i studimit MP nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të dijeve, në një vit akademik, përvec moduleve bazë të menaxhimit ofron dhe module specifike duke i dhënë mundësinë studentëve të jenë më pranë tregut të punës. Në këtë program universiteti ka si objektiv ofrimin e kushteve optimale të zhvillimit të mësimin dhe angazhimin e një stafi të kualifikuar.</p> <p>Metodat e vlerësimit që janë përmendur në syllabus dhe nga takimet me stafin akademik dhe studentët, janë ndër metodat që përdoren sot gjerësisht në mësimdhënie, duke i përfshirë studentët në mënyrë aktive, të jenë të interesuar dhe dinamik në përftimin e dijeve dhe aplikimin e njohurive.</p>
Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavejeçare dhe praktikat e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomatat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Për hartimin e programit të studimit, UMSH është mbështetur në eksperiencën europiane por dhe në eksperiencën më të mirë shqiptare. Programi ka nisur në vitin 2011 mgjse numri i studentëve ka qënë i kufizuar. Diploma që përfitohet në fund të programit dhe suplementi i diplomës lejojnë studentin të transferohet në një IAL jashtë vendit për studime të mëtejshme.</p> <p>Programi është hartuar në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe orientohet nga integrimi europian i vendit dhe zhvillimi ekonomik i tij.</p>
Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p>	<p>Programi i studimit MP ka një përputhje të njohurive teorike me ato praktike. Studentët ndjekin një praktikë profesionale përpara diplomimit, duke i afuar më shumë me tregun e punës.</p>

<p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Objektivat e programit të studimit përputhen me strategjitë e institucionit. Sipas RVB programi i studimit në veprimtarinë e tij paraqitet në përputhje me planin strategjik të zhvillimit institucional dhe kërkimit shkencor. Përfshirja e një stafi akademik të kualifikuar tregon për cilësi të mësimdhënies. Stafi akademik efektiv është në proces kualifikimi dhe është i përfshirë maksimalisht në punë kërkimore shkencore. Nga vizita në institucion dhe bisedat me ta u vu re përfshirja e tyre në konferenca dhe pjesëmarrja në revisten e vet institucionit. Përfshirja e pjesës më të madhe të tyre në proces doktorature, është nxitje për punë kërkimore shkencore.</p>
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>Tregu i punës për këto profile është shumë specifik dhe kjo është një arsye më shumë pse institucioni duhet të kryejë studim të mirëfilltë tregu për këtë PS. Institucioni ka paraqitur në dokumentacion një studim tregu, por së pari studimi është për të gjitha programet që universiteti ofron dhe së dyti nuk përmban elementët e një studimi të mirëfilltë ku të nxjerr konkluzionet mbi kërkesat e tregut për këtë grup të diplomuarish.</p>
<p>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Institucioni nuk ka paraqitur një studim tregu për këtë program studimi. Studimi i tregut do të përcaktonte më saktë numrin e studentëve të diplomuar për të cilët tregu ka mangësi.</p> <p>Ne rekomandojmë që institucioni duhet të përgatisë një studim të mirëfilltë tregu në mënyrë që kuotat e përcaktuar të jenë në të njëjtin kah me zhvillimet e tregut.</p> <p>Në objektivat e programit të studimit, institucioni përmend se të diplomuarit në këtë PS mund të punësohen në:</p> <ul style="list-style-type: none"> Në administratë publike Në administratën e institucioneve private Në organizma dhe organizata ndërkombëtare rezidente në Shqipëri, në organizata të shoqërisë civile, etj. <p>Por për këto konkluzione nuk janë mbështetur në studim tregu.</p>
<p>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtarë;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi MP është hapur në mbështetje të Urdhërit nr 482 datë 03.10.2011 të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe nuk bie ndesh me interesat kombëtare, duke pasur synim parësor ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>
<p>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p>	

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>Programi është Master Profesional</p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p>Programi është MP me 60 kredite. Kohëzgjatja e tij është 1 vit. Programi ka reflektuar këtë strukturë që në momentin e parë të hapjes se tij. 28 ECTS studentët i marrin nga formimi bazë dhe 32 ECTS janë specifike sipas profilit. Gjithsej programi ka 7 provime+ praktika + diploma/provimi përfundimtar.</p>
<p>Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	<p>Master Profesional me profile.</p>
<p>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët; Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>PS ofron një kurrikul lehtësisht të kuptueshme ku secili modul jepet nga syllabusi përkatës. Syllabuset nuk kanë pësuar asnjë ndryshim gjatë gjithë kohës së funksionimit të këtij programi. Kjo vihet re dhe nga formati i tyre por dhe nga emrat e pedagogëve që i kanë formuluar.</p> <p>UMSH, siguron në këtë program studimi të gjithë informacionin e nevojshëm mbi modulet dhe syllabuset duke i vendosur në faqen zyrtare online në internet të Institucionit dokumentacion që na u vendos në dispozicion dhe GVJ-së. Studentët mund ta marrin informacionin dhe në sekretari. Instucioni ka vënë në dispozicion të grupit të Vlerësimit të Jashtëm të gjithë këtë informacion të nevojshëm.</p> <p>Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme, nga pedagogu i lëndës në auditor, të shkruara dhe elektronikisht. Studentët kanë mundësi që për cdo paqartësi apo problem të komunikojnë me pedagogun që kryen tutoriatin.</p>
<p>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</p>	
<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar; Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Diplomimi përmbillet me provim ose me përgatitje të një teme diplome në fund të studimeve sipas deklarimeve gjatë vizitës në institucion me studentët. Ky projekt ka 8 kredite. Institucioni duhet të përshtasë ndarjen e moduleve në veprimtari sipas VKM, nr.41 dt 24.1.2018</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. UMSH ka në themel të punës kërkimore shkencore, respektim rigoroz të procedurave të kërkuara dhe urdhëruar nga Ligji për Arsimin e Lartë dhe MASR. 2. Kurrikulat janë të qarta dhe nuk kanë pësuar ndryshime vetëm në një rast që është evidentuar në raport ku dy module janë përshtatur në emërtim dhe syllabus pa ndryshuar strukturën e planit mësimor. 	

3. Organizimi i programit te studimit është në përputhje me stadardet europiane, sipas të cilave lëndët ndahen në sistemin european të krediteve ETCS. Institucioni duhet të adaptojë në të ardhmen VKM nr.41 dt 24.01.2018 për ndarjen e moduleve sipas disiplineve te ngjashme formuese.
4. Numri i studentëve në dy vitet e para të hapjes së programit jepet në total dhe jo i ndarë sipas profileve. Në vitet e tjera akademike vihet re një rënie e numrit të studentëve në profilin Arsim, Art, Pasuri e paluajtshme dhe nje rritje e vogël në profilet Shëndetësi dhe Turizëm. Studimi i tregut do të ndihmonte në profilizimin më të mirë të studentëve.

Standarti plotësohet pjesërisht. Institucioni duhet të kryejë një studim tregu për të justifikuar më mirë domosdoshmërinë e pasjes së pesë profileve të ndryshëm në të njëjtin program studimi dhe risku nga IAL e tjera që ofrojnë programe të ngjashme është i lartë.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Mësimdhënia është një aspekt i rëndësishëm për një program studimi, sepse format e mësimdhënies përcaktojnë edhe nxënien dhe cilësinë e mësimdhënies.

Format kryesore të mësimdhënies janë leksionet, seminarët.

Format e mësimdhënies që janë përdorur në realizimin e programit të studimit MP Menaxhim Biznesi me profile janë leksionet, seminarët, ushtrimet praktika profesionale dhe orët e konsultimit. Në lëndët e programit është aplikuar zhvillimi interaktiv i leksioneve duke trajtuar çështjet kryesore të leksionit dhe duke u përpjekur të tërheqim vëmendjen e studentëve me pyetje të ndryshme, në mënyrë që leksioni të jetë sa më tërheqës dhe i kuptueshëm për ta. Është ndjekur kjo formë mësimdhënie edhe me qëllim që ndjekja e leksionit të mos kthehet në një detyrim rutinë për studentin, por të jetë sa më efektiv në arritjen e qëllimit që synohet nëpërmjet dhënies së leksioneve, që studenti të ketë mundësi të kuptojë më mirë çdo çështje që pedagogët synojnë të shpjegojnë nëpërmjet leksioneve.

Leksionet zhvillohen në bazë kursi. Seminarët me grupe më të vogla studentësh. Në standartin e mëparshëm kemi paraqitur orët në auditor dhe orët që punojnë studentët në mënyrë të pavarur me detajimet përkatëse.

Leksionet në shumë lëndë janë sa dyfishi i seminareve ku është pedagogu ai që shpjegon dhe analizon tematikat përkatëse, ndoshta mund të shihet si mundësi një balancim orësh leksione dhe seminare për të mos lodhur studentët me shumë orë leksioni në të njëjtën lëndë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies (ndarja e orëve në auditor) për programin e studimit Msc Financë-Bankë janë të detajuara si më poshtë:

▪ Për leksionet	270 orë në auditor
▪ Për Seminarët	200 orë në auditor
▪ Për Praktikën Profesionale	120 orë në auditor
▪ Ushtrime	10 orë në auditor
▪ Provimi përfundimtar (Diplomimi)	25 orë në auditor
▪ Orë jashtë auditorit	875 orë

Forma kryesore e kontrollit të dijës është provimi. Sipas rregullores mënyra të tjera të kontrollit të dijës mund të përcaktohen nga njësia bazë dhe miratohen nga njësia kryesore në programin e cdo lënde apo moduli. Në të gjithë syllabuset përcaktohet si formë e kontrollit të njohurive provimi përfundimtar.

Në syllabuse përcaktohen edhe pikë vlerësimi nga aktivizimi dhe frekuentimi në seminar si dhe për detyra apo projekte kursi. Nga syllabuset mund të themi se provimi përfundimtar zënë rreth 60 % të vlerësimit të kontrollit të njohurive.

Sipas RVB numri i studentëve të aktivizuar në projekte shkencore në rang fakulteti është 12 por jepen dhe një numër i studentëve të përfshirë në projekte të departamentit apo të vet pedagogëve. Institucioni nuk ka dorëzuar ndonjë dokument ku të tregohet përfshirja e këtyre studentëve në këto veprimtari. Megjithatë studentët e këtij programi ishin pjesëmarrës aktiv në Panairin e Ideve.

9. Studentët

Pjesa përshkimore

Procedurat e pranimit të studentëve bazohen në rregulloren e institucionit dhe bazë është cdo përcaktim ligjor i kriterëve të pranimit. Nga të dhënat e ofruara nga institucioni vihet re një rritje e qëndrueshme e numrit të studentëve të cilët ndjekin këtë program studimi. Programi i studimit megjithese është hapur në vitin akademik 2011-2012 dhe në vitin 2012-2013 ka pasur 28 studentë, nuk ka mundur të bëhet atraktiv ku dhe në vitin e fundit akademik 2017-2018 numri i studentëve është 36. Kemi këto rezultate të regjistrimit të studentëve në total për të 5 profilet:

- 2012-2013 28 studentë
- 2013-2014 15 studentë
- 2014-2015 23 studentë
- 2015-2016 28 studentë në RVB ne sekretari 25 studentë
- 2016-2017 30 studentë në RVB në sekretari 27 studentë
- 2017-2018 36 studentë ku në profilin Menaxhim Arti nuk ka të regjistruar asnjë student

Nga këto të dhëna rezulton se ka pa numër matrikullimi:

- 2014-2015 – 5 (pesë) studentë pa numër matrikullimi
- 2015-2016 – 3 (tre) studentë pa numër matrikullimi
- 2016-2017 – 2 (dy) studentë pa numër matrikullimi

Pranimi i studentëve të rinj për të ndjekur studimet në Fakultetin e Shkencave Ekonomike në programin e studimit MP me profile bëhet bazuar në legjislacionin në fuqi të përcaktuar nga Ministria përgjegjëse për arsimin, në Statutin dhe Rregulloren e Organizimit të UMSH dhe në Rregulloren e Programit të Studimit.

Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit bëhet publik në faqen zyrtare të UMSH, në broshurën informuese dhe gjatë fushatës së marketingut.

Procesi i informimit të studentëve të ardhshëm koordinohet nga Sekretaria Mësimore dhe Pranimet në bashkëpunim me ZKSK.

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Procedura e pranimit të studentëve jepet në rregulloren e Programit të studimit MP Menaxhim Biznes. Sipas vendimit të Universitetit Mesdhetar Nr.2/1, datë 07.02. 2018 për përcaktimin e kriterit të pranimit të studentëve Universiteti Mesdhetar bazohet në Ligjin 80/15 “Per arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”. Për ciklin e dytë të studimit kriteri bazë për pranimet për vitin 2018-2019, është nota mesatare minimale përcaktuar nga vendimi i Këshillit të Ministrave për këtë vit akademik dhe zotërimi i diplomës së nivelit të parë të studimeve.

Studentët e regjistruar në vitin e parë akademik 2012-2013 janë 28 ndërsa në vitin e fundit akademik janë 36 studentë. Nota mesatare në hyrje varion nga 6.3-8.3 sipas profileve. (Tabela 10). Institucioni pas vizitës ka dorëzuar të dhënat mbi mesataren në dalje të studentëve. Vihet re se studentët ruajnë të njëjtën mesatare si ajo në hyrje. Përsa i përket diplomimeve vihet re se:

- 2012-2013 - 16 studentë të diplomuar
- 2013-2014 - 6 studentë të diplomuar
- 2014-2015 - 0 studentë të diplomuar
- 2015-2016 - 22 studentë të diplomuar
- 2016-2017 - 17 studentë të diplomuar

Gjithsej numri i të diplomuarve në këtë program studimi është 61 studentë nga viti 2013-2017. Nr total i të punësuarve sipas diplomës është 37. (Tabela 11)

Universiteti Mesdhetar ka një procedurë të qartë të transferimit të studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend. Procedura e transferimit bazohet në Udhëzimet që nxjerr MASR në vitin akademik përkatës, në udhëzimet që nxjerr vet UMSH dhe në Statutin dhe rregulloren e UMSH. Sipas procedurës studentët bëjnë kërkesë pranë dekanatit dhe ky i fundit merr vendimin e transferimit bazuar në Udhëzimet dhe rregullat e përmendura më sipër. Nga të dhënat që disponojmë nga institucioni shihet që institucioni ka studentë të transferuar pranë tij nga universitetet e tjera brenda vendit, e verifikuar edhe nga rregjistrat në vizitën në institucion. 25 studentë janë transferuar në këtë program që nga fillimi i funksionimit të tij.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
 - Të dhëna mbi të regjistruarit dhe të diplomuarit.
 - Përmbledhje e procedurës së transferimit.
 - Kriteret e pranimit të studentëve 2018-2019 UMSH.
 - Udhëzim praktikat

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimit në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si</p>	<p>Për pranimin në ciklin e dytë të studimeve “Master Profesional” kandidatët duhet të kenë përfunduar me diplomim studimet universitare të ciklit të parë në përputhje me aktet ligjore dhe Rregulloren e Programit të Studimit.</p> <p>Universitetit Mesdhetar i Shqipërisë merr vendim në lidhje me kriteret e pranimit të studentëve dokumentacion që u vu në dispozicionin tonë pas vizitës në institucion. Vendimi i senatit akademik 2/1 dt 7/02/2018 miraton kuotat e pranimit të studentëve në programin e ciklit të parë dhe të dytë të studimit si dhe kriteret e pranimit në programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë.</p> <p>Përzgjedhja e kandidatëve për pranim në Fakultetin e Shkencave Ekonomike bëhet nga një komision i caktuar</p>

<p>dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kritereve të pranimit.</p>	<p>nga Dekani, mbështetur në dokumentacionin e paraqitur si dhe nga shqyrtimi i dosjes personale të kandidatit.</p> <p>Gjithashtu UMSH merr parasysh edhe mundësinë e vendosjes së kritereve shtesë për pranimin e studentëve ne bazë të statutit dhe rregullores.</p>
<p>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikën e punësimit.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve në momentin e fillimit të studimeve. Studentët informohen për të gjitha këto që në momentin e aplikimit për ndjekjen e studimeve pranë UMSH.</p> <p>Në përfundim të çdo semestri studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde me anë të një pyetësoi që ju jepet për tu plotësuar nga departamenti përgjegjës.</p> <p>Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës nëpërmjet Zyrës së këshillimit të karrierës. Në UMSH përveç zyrës së karrierës funksionon edhe sistemi tutorial, ku një pedagog ndjek ecurinë, problematikat dhe këshillon studentët për të cilët ai është tutori.</p> <p>Një pedagog është tutori i dy grupeve mësimore me studentë.</p> <p>Nëpërmjet Zyrës së këshillimit të karrierës studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>
<p>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, për numrin e të transferuarve drejt institucionit nga Institucione të tjera të arsimit të lartë brenda vendit.</p> <p>Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, u vunë re problematika në plotësimin e regjistrave. Data e diplomimit në regjistrë ishte shënuar gabim. Po kështu regjistri i notave nuk ishte uniform në plotësim. Staf i administrativ në ngarkim të sekretarisë, nuk mund të jepte përgjigje për mënyrën e plotësimit të regjistrave.</p> <p>Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuar, në ciklin e dytë, për mesataren me të cilën janë pranuar. Këto të dhën u vunë në dispozicion nga institucioni pas vizitës në terren.</p>
<p>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	

<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Nga biseda në Institucion rezultoi se institucioni u ofron këshillim karriere studentëve nëpërmjet zyrës së këshillimit të karrierës.</p> <p>Tutorët e përcaktuar të studentëve ndjekin ecurinë e studentëve dhe të gjitha çështjet apo problematikat që kanë të bëjnë me procesin mësimor.</p> <p>Institucioni ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, gjë e cila na u pohua nga studentët gjatë takimit me ta.</p> <p>Për kryerjen e praktikave institucioni ka lidhur një sërë marrëveshje bashkëpunimi me institucione apo biznese të ndryshme.</p> <p>Çdo pedagog mbikëqyr studentë në praktikë. Ky PS ka një numër të vogël studentësh dhe tutoriati është më i thjeshtë.</p> <p>Studenti dorëzon dosjen e praktikës në bazë të rregullores së praktikës. Për Praktikën profesionale studentit vlerësohet me notë.</p> <p>Pas diplomimit lidhjet me studentët zbehen dhe sic shikohet informacioni për punësimin nuk është i plotë i dhënë sipas viteve akademike. Tabela 11</p>
--	--

Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.

<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve në momentin e fillimit të studimeve. Studentët informohen për të gjitha këto që në momentin e aplikimit për ndjekjen e studimeve pranë UMSH.</p> <p>Në procesin e informimit dhe pranimit të studentëve jepet një informacion i detajuar për programin, për kohëzgjatjen, ngarkesën si numër lëndësh dhe pedagogët që i zhvillojnë</p>
---	--

Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.

<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Nga bisedat me studentët, u vu në dukje ofrimi i shërbimit të këshillimit të karrierës nëpërmjet Zyrës së këshillimit të karrierës. Në UMSH përveç zyrës së karrierës funksionon edhe sistemi tutorial, ku një pedagog ndjek ecurinë, problematikat dhe këshillon studentët për të cilët ai është tutori.</p> <p>Një pedagog është tutori i dy grupeve mësimore me studentë.</p> <p>Departamenti ka kontakte të vazhdueshme me studentët, duke i orientuar ata mbi programet dhe kurrikulat e lëndëve si dhe mbi lëndën me zgjedhje, praktikat profesionale etj. Kjo na u bë e ditur nga Departamenti dhe gjatë bisedës me studentët.</p> <p>Informacioni u përcillet studentëve nga departamenti si dhe pedagogu i lëndës. Cdo syllabus përmban informacionin e nevojshëm rreth mënyrës së vlerësimit,</p>
---	--

literaturën, frekuntimin dhe elementë të tjerë të nevojshëm për informimin e studentëve.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve në momentin e fillimit të studimeve.
2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, megjithatë u vu re se institucioni kishte probleme në plotësimin e regjistrave.
3. Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës nëpërmjet Zyrës së këshillimit të karrierës. Në UMSH përveç zyrës së karrierës funksionon edhe sistemi tutorial, ku një pedagog ndjek ecurinë, problematikat dhe këshillon studentët.
4. Institucioni ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale.

Standarti plotësohet pjesërisht Institucioni duhet të punojë në përmirësimin e sekretarisë mësimore, në kualifikimin e stafit administrativ, pasi nga vizita në institucion u vunë re probleme të cilat u vunë në dukje nga GVJ.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Kërkimi shkencor si një faktor shumë i rëndësishëm për institucionet e arsimit të lartë është institucionalizuar jo vetëm me hapjen e zyrës së kërkimit shkencor po edhe me pozicionin e një zv. Rektori për zhvillimin dhe mbikëqyrjen e kërkimit shkencor.

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka ngritur në përbërje të njërive kryesore edhe Qendrën e Kërkimit Shkencor e cila mbikëqyr kërkimin shkencor të stafit dhe studentëve. Gjithashtu është ngritur për këtë qëllim edhe zyra e projekteve.

Politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi konsiston në rritjen e nivelit shkencor të pedagogëve, nëpërmjet botimeve në revista shkencore, pjesëmarrje në konferenca, nxitje të marrjes së gradës Phd në universitete të huaja.

Cdo fundviti institucioni pasi bën vlerësimin e performancë së stafit, nxjerr edhe detyrat e ardhshme në lidhje me kualifikimet dhe kërkimin shkencor të secilit.

Nga biseda me pedagogët, u vu re mbështetja që institucioni bën financiarisht stafit për avancimin e karrierës së tyre dhe specifikisht në drejtim të kërkimit shkencor duke paguar tarifat e botimeve apo publikimit si dhe shpenzime të tjera mbështetëse. Institucioni mbështet edhe botime librash dhe monografish me kërkesë të pedagogëve.

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë boton revistën shkencore me Bord Editorial EUROMEDITERRANEAN ku pedagogët kanë mundësi të ballafaqojnë mendimet e tyre shkencore.

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë organizon Konferencë Ndërkombëtare Shkencore vjetore. Në Konferencën Shkencore ftohen të marrin pjesë edhe studentët. Studentët marrin pjesë në mënyrë aktive në aktivitetin shkencor të studentëve Panairin e Ideve që organizon UMSH cdo vit.

Po në funksion të ndjekjes së politikës së kërkimit shkencor institucioni ka lidhur shumë marrëveshje bashkëpunimi me organizma qeveritarë, institucione vendase dhe të huaja si dhe aplikon për të qenë pjesëmarrës në projekte të ndryshme.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor (Tabela 12 ne aneks). Nuk jep detaje per projektet, ciles periudhe kohore dhe stafi i kujt departamenti eshte perfshire. Cila eshte lidhja me këtë program studimi?

Në dokumentacionin e derguar nga Institucioni UMSH janë CV e pedagogëve, në përbërje të të cilave duket një aktivitet shkencor i bollshëm dhe shkencor. Pedagogët kanë marrë pjesë në një numër të konsiderueshëm konferencash dhe kanë publikime në revista të ndryshme shkencore. Gjithashtu disa nga pedagogët janë edhe autorë librash universitar.

Sipas të dhënave nga informacioni i dhënë nga UMSH dhe nga RVB janë 3 projekte të fituara, njëri ka përfunduar ndërsa dy janë në proces.

Sipas të dhënave nga informacioni i dhënë nga UMSH dhe nga RVB janë 3 projekte të fituara dhe të zbatuara. Dy nga projektet janë pjesë e programit Erasmus +, njëri është në vijim ndërsa tjetri ka përfunduar. Projekti i tretë që është në vijim është pjesë e EU Programme: European cooperation for Science and Technology.

Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga UMSH janë 7, sipas RVB. Sic është përmendur më sipër Institucioni organizon Konferencë Ndërkombëtare Shkencore dhe Panairin e Ideve.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Personeli akademik efektiv, sidomos ata të cilët janë të përfshirë në proces doktorature, janë aktiv në punën kërkimore shkencore. Një fakt i tillë rezulton dhe nga statistikatat, të cilat mbahen periodikisht, por dhe nga të dhënat e përgjithshme që disponon departamenti Ekonomisë apo raportimet individuale të secilit pedagog.</p> <p>Institucioni ka një revistë shkencore jo periodike, dhe zhvillon konferenca shkencore dhe në bashkëpunim me Universitete të tjera në vend.</p>
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Institucioni nuk ofron programe në gjuhë të huaj. Kjo e bën të vështirë këmbimin në programet Erasmus+.</p> <p>I rekomandojmë institucionit që të ofrojë leksione në gjuhë të huaj në mënyrë që të tërheq studentë të huaj në këtë program studimi.</p>
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtjshëm të personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtjshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtjshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>Institucioni ka përkrahur në mënyrë të vazhdueshme personelin akademik që është në fazë kualifikimi.</p> <p>Institucioni ka ndihmuar stafin për pjesëmarrje në konferencat apo botimet e vet Universitetit pa pagesë.</p>

	Institucioni gjithashtu garanton vijueshmërinë në punë të stafit i cili shkeputet për kualifikime të mëtejshme me iniciativë personale.
Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” disponon të dhënat për studimet shkencore të personelit akademik të angazhuar në programin Master i Shkencave në Financë Bankë. Këto të dhëna janë të aksesueshme dhe lehtësisht të verifikueshme pasi në departament disponohen dosjet përkatëse mbi publikimet shkencore të stafit.</p> <p>Universiteti disponon dhe të dhënat për përfshirjen e institucionit në projekte të ndryshme.</p> <p>Institucioni ka vënë në dispozicion të gjithë dokumentacionin përkatës në këtë rast.</p>
Konkluzionet e vlerësimit:	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Institucioni ka prioritet kërkimin shkencor. Stafi akademik efektiv është i përfshirë në proces doktorature dhe kjo bën që kërkimi shkencor të jetë në qendër të diskutimeve në nivel departamenti. 2. Institucioni ka paraqitur një listë të projekteve ku Universiteti ka aplikuar dhe është përfshirë megjithatë në pasqyrat financiare nuk përfshihet si zë të ardhurat nga projektet. 3. Institucioni disponon në dosjet e pedagogëve, informacion në lidhje me punën shkencore të cdo anëtari të departamentit. 4. Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” ka krijuar struktura të posaçme për mbarëvajtjen dhe mbikqyrjen e vazhdueshme të rritjes së punës shkencore. Tregues konkret të sa më sipër janë organizimi i konferencave shkencore, botimet në revistat me faktor impakti si dhe vetë punimet e stafit akademik dhe i studentëve në nivelin Master. <p>Nga sa më sipër për çështjen 10. Kërkimi shkencor, standarti plotësohet</p>	

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Pranë Institucionit është ngritur Zyra e projekteve. Zyra e Kërkimit Shkencor dhe Zyra e projekteve merret me aplikime në projekte të mundshme, dhe ndjek zbatimin e tyre. Këto dy zyra në bashkëpunim, si dhe drejtuesit e institucionit kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me pushtetin lokal, dhomën e tregtisë, biznese të ndryshme, me universitete brenda dhe jashtë vendit. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë është pjesë e programit ERASMUS por mobilitetet nga programi nuk janë shfrytëzuar maksimalisht.

Institucioni ka organizuar në mënyrë të vazhdueshme leksione me lektorë vendas dhe të huaj si dhe tryeza të rrumbullakëta diskutimesh. Institucioni ka vënë në dispozicion të GVJ një listë me rreth 31 aktivitete ekstrakurrikulare të organizuara gjatë këtij viti akademik.

Leksionet që janë zhvilluar kanë qenë pjesë e bashkëpunimeve kombëtare ose ndërkombëtare ose lektorët kanë qenë të ftuar nga Institucioni për të zhvilluar leksione në tematika të ndryshme. Leksionet me lektorë të huaj kanë qenë 218 orë mësimore.

Institucioni në dokumentacion ka dhënë një kopje të marrëveshjeve me të gjitha specifikat e tyre. Në to përcaktohet qartë qëllimi, parimet e bashkëpunimit si dhe kushtet e bashkëpunimit sipas kërkesave të bashkëpunimeve.

Numri i pjesëmarrësve në trajnime në fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit sipas RVB janë 8. Institucioni mbështet kërkimin shkencor jashtë vendit duke mundësuar dhe financuar aktivitetet akademike jashtë vendit. Institucioni ofron mbështetje për mobilitete të stafit akademik dhe për mobilitete të studentëve si dhe për studime në ciklin e tretë të studimeve jashtë. Sipas RVB 3 studentë të UMSH kanë përfituar nga projekte Erasmus+.

